



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.06.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit të punimeve për periudhën 20 qershor – 8 korrik
2. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës i aktit normativ nr.10, datë 15.5.2022 “Për kompensimin financiar të çmimit për disa materiale ndërtimi, sipas përcaktimeve në kontratat publike për punë, si pasojë e situatës së veçantë, të krijuar në treg gjatë vitit 2022”
3. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit “Për krijimin dhe funksionimin e Parqeve Teknologjike dhe Shkencore”
4. Miratimi i draft-rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të KLSH-së për vitin 2021

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Arbi Agalliu, Benet Beci, Erion Braçe, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Antoneta Dhima, Edmond Spaho, Enslemvera Zake, Anila Denaj, Pranvera Resulaj.

Mungojnë:

Blerina Gjylameti, Alfred Rushaj, Agron Shehi, Jorida Tabaku, Emilja Koliqi, Dashamir Shehi, Shpresa Marnoj, Bujar Leskaj.

Të ftuar:

Adela Xhemali - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhëmbi – Drejtor i Përgjithshëm i Buxhetit në MEF

Idlir Gjata – Këshilltar në MFE

Illir Bejtja - Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Gentian Gjyli - Drejtor i Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes (ARRSH)

Genti Raça - Përgjegjës i Preventivit (ARRSH)

Besart Kadia – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Saimir Mucmataj – Drejtor i Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator

Ermal Frashëri - Drejtor i Përgjithshëm i Korporatës së Investimeve Shqiptare (AIC)

Nikolla Llera – Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve
fiskale

Evis Fico – Këshilltare në MFE

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Në vijim të agjendës së njoftuar paraprakisht, mbledhjen e deklaroj të hapur!

Në rendin e ditës sot kemi 4 çështje. Do ta fillojmë me çështjen e parë miratimin e kalendarit të punimeve për periudhën 20 qershor 10 korrik. A ka ndonjë koleg që ka ndonjë koment apo sugjerim?

Nëse nuk ka e miratojmë këtë pikë dhje kalojmë te pika e dytë që është shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës të aktit normativ nr 10, datë 15.5.2022 “Për kompensimin financiar të çmimit për disa materiale ndërtimi, sipas përcaktimeve në kontratat publike për punë, si pasojë e situatës së veçantë, të krijuar në treg gjatë vitit 2022”

Relatore kemi zonjën Pranvera Resulaj. Ndërkohë që për prezantimin e aktit normativ kemi të ftuar përfaqësues nga dy ministri, zotin Ilir Bejtja, Gentjan Gjyli dhe Genti Raca, respektivisht zëvendësministër dhe drejtori i Mirëmbajtjes, si edhe përgjegjës të sektori të Preventimit në ARRSH nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ndërkohë nga Ministria e Financave dhe të Ekonomisë kemi zonjën Adela Xhemali zëvendësministre, zonjën Mimoza Dhëmbi drejtore e Buxhetit si edhe zotin Ildir Gjata këshilltar.

Fjala për zëvendësministrat.

Zonja Xhemali, fjala për ju.

Adela Xhemali – Faleminderit!

Akti normativ që është paraqitur para jush për diskutim dhe miratim propozohet me qëllim zgjidhjen e problematikave të krijuara nga rritja e çmimeve të hekurit, çimentos, bitumit, tubave plastikë, të aluminit, të bakrit dhe zinkut në kontratat publike për punë. Situata e veçantë e krijuar nga efektet e luftës në Ukrainë, por jo vetëm, ka krijuar një problematikë me ecurinë e investimeve publike. Ngritja e ndjeshme e çmimeve në treg për materialet e ndërtimit ka ndaluar ose ngadalësuar një pjesë të kontratave publike, pasi ecuria e mëtejshme do të shkaktonte humbje të parikuperueshme për kompanitë e ndërtimit deri në falimentimin e tyre. Kjo situatë do të detyronte shoqëritë të ndërprisnin punimet dhe si pasojë do të kishim shtyrje të përfundimit të objekteve, shoqëruar kjo me efekte anësore negative respektive.

Duke analizuar vetëm shifrat e zbatimit të buxhetit të shtetit për periudhën 5 mujore vërehet se niveli i investimeve publike me financim të brendshëm është ngadalësuar duke arritur

në 14% të totalit të shumës së programuar për vitin 2022 nga 31% që ka qenë në të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Nëpërmjet këtij akti synohet të përcaktohen rregullat për kompensimin financiar të çmimeve të disa materialeve të ndërtimit që kanë pasur rritjen më të madhe në treg.

Procedura e përfitimit të kompensimit është përcaktuar me detaje dhe realizohet në formën e kontratës shtesë për punë që kryhen pas miratimit të këtij akti. Pagesat konkrete realizohen kundrejt punës së kryer brenda kontratës shtesë të miratuar dhe pas verifikimit të përdorimit të materialeve të përcaktuara në këtë akt mbështetur në situacionin e punimeve dhe faturën e blerjes. Kompensimi për secilin operator ekonomik, që përmbush kriteret e këtij akti normativ, bëhet në masën nga 5%-30 % të vlerës që zënë materialet e ndërtimit të mësipërme në kontratat respektive. Shtesa e kontratës mban parasysht vetëm pjesën e projektit që parashikohet të zbatohet për gjatë vitit 2022. Me qëllim shmangien e abuzimeve është parashikuar që strukturat shtetërore dhe autoriteti kontraktor mund të kryejnë edhe verifikime në vend në rast konstatimi të pasaktësive në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëritë. Përfitues të këtij kompensimi janë kompani që kanë kontrata me institucionet e qeverisjes qendrore vendore dhe shoqëritë me kapital shtetëror mbi 51% si edhe disa projekte me financim të huaj.

Akti normativ i shtrin efektet e tij gjatë periudhës së emergjencës për shkak të situatës së veçantë të krijuar në treg. Hyrja në fuqi e këtij akti konsiderohet si shpallje e situatës së veçantë dhe mbarimi i saj përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për llogaritjen e përafërt të efekteve financiare janë marrë në analizë projektet në proces për kontrata të lidhura nga 1 janari i vitit 2020, në të cilat peshën specifike më të madhe e zënë materialet e ndërtimit të përmendura më sipër.

Akti përcakton se efektet financiare përballohen nga buxheti i shtetit i miratuara për njësitë e qeverisjes qendrore, buxhetet vendore dhe fondet e shoqërive me kapital shtetëror.

Megjithatë Ministria e Financave do të ndjekë hap pas hapi zbatimin e këtij akti duke bërë axhustimet e nevojshme të fondeve me qëllim që efektet financiare shtesë të mos ndikojnë në sektorë të tjerë publikë.

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Faleminderit!

Zonja Resulaj, fjala për ju.

Pranvera Resulaj - Faleminderit!

Akti normativ nr.10 propozohet nga Këshilli i Ministrave dhe vjen në përputhje me nenin 101 të Kushtetutës duke përmbushur kriteret e nevojës së urgjencës dhe përputhshmërisë pasi merr fuqinë e ligjit deri në 45 ditë sa miratohet nga parlamenti. Do të ndalem në disa çështje kryesore.

Për kë bëhet së pari, ky kompensim i çmimit të materialeve të ndërtimit, sikurse edhe zëvendësministrja i specifikoi? Dinamika e ndryshimit të çmimeve gjatë vitit 2022 ka vënë në vështirësi zbatimin e kontratave publike për punë nga ana e autoriteteve kontraktore, të cilat janë ata që do të përfitojnë nga kompensimi siç janë njësitë e vetëqeverisjes vendore, njësitë e qeverisjes qendrore, njësitë zbatuese të kontratave në kuadër të procesit të rindërtimit dhe enteve të tjera publike, si edhe kontrata publike të shoqërive me kapital shtetëror ku shteti ka mbi 50 % të aksioneve.

Cilat janë kontratat që përfitojnë kompensimin? Kontratat që janë në proces për t'u lidhur para hyrjes në fuqi të këtij akti normativ përfitojnë nga kompensimi i çmimit të materialeve të ndërtimit dhe, gjithashtu, kontratat që janë në proces zbatimi nga janari i vitit 2020. Duket se nuk përfitojnë ata që janë përmbushur ose përfunduar nga viti 2020-2022, edhe pse janë prekur ndoshta nga ndryshimet e çmimeve. Masa e kompensimit financiar, ashtu siç shprehet në nenin 6, është nga 5-30 % të materialeve respektive të ndërtimit në kontratat publike. Kompensimi jepet vetëm për pjesën që lidhet e rritjen e çmimit të materialeve të ndërtimit.

Për procedurat për përfitimin e kompensimit operatorët paraqesin kërkesën për kompensimin financiar pranë autoriteteve kontraktore. Kërkesa përmban vlerën e parashikuar në kontratë për punimet gjatë vitit 2022, si edhe vlerën e parashikuar për përdorimin e materialeve gjatë vitit 2022, si edhe vlerën për kompensim, që do të thotë, që është diferenca mes vlerës së parashikuar dhe asaj në zbatim. Autoritet kontraktore hartojnë shtesat e kontratave dhe i paraqesin në ministritë e linjës, Komitetit Shtetëror të Rindërtimit dhe bordeve drejtuese, si edhe këshillave bashkiake.

Autoritet kontraktore realizojnë më tej kompensimin. Sa zgjat periudha e zbatimit të aktit normativ? Ashtu sikurse e tha edhe zëvendësministrja, zgjat aq sa është periudha e situatës së veçantë të rritjes së çmimeve, pra nga 18 maj i vitit 2022 deri në një vendim të Këshillit të Ministrave për përfundimin e kësaj situatë. Gjithashtu, në rast se operatori nuk bie dakord me vlerën e kompensimit, kontrata zgjidhet dhe hapet një procedurë e re prokurimi për realizimin e punimeve të papërfunduara dhe ndaj operatorëve merret masa e përjashtimit nga prokurimi

publik për 3 vjet. Vonesat nga ana e operatorit nuk do të quhen shkelje dhe nuk do të aplikohen penalitete për to. Për kontratat që do të lidhen pas hyrjes në fuqi të këtij akti normativ do të respektohen çmimet e tregut. Sa i përket efekteve financiare sigurisht, që ka kosto të shtuar financiare, do të përballohen nga buxheti i shteti i vitit 2022 i bashkive dhe buxheti i shoqërive aksionere, të cilat janë pjesë e përfitimit.

Këto janë pikat kryesore që përmban kontrata.

Nëse kryetari më lejon unë do të bëj edhe pyetjet.

Pyetja e parë i përket nenit 6 dhe lidhet me masën e kompensimit të shtesës së kontratës nga 5-30% që duket se është një diapazon i gjerë i kësaj vlere kompensimi për materialet e ndërtimit hekur, bitum çimento, tuba plastikë, alumin bakër dhe zink, sepse këto janë elementet që preken nga kompensimi i çmimit. Nëse ku diapazon shkon nga 5-30% si do të vlerësohet masa e kompensimit dhe a gjykoni se do të ketë subjektivizëm në vlerësimin e kësaj mase?

Së dyti, a ka një për afrim të shumë s të këtij efekti financiar dhe nëse ka një për afrim në total po në zëra sa do të ishte efekti financiar për njësitë zbatuese të kontratave në kudër të procesit të rindërtimit dhe mandej në ato të një sive të qeverisjes vendore dhe qendrore?

Eduard Shalsi - Zoti Braçe.

Erion Braçe – A mund të kemi një listë të kontratave konkretisht qoftë të punëve publike që janë infrastrukturë nga shkollat deri te rrugët, qoftë edhe të kompanive me kapital shtetëror? Ju thoni se në këtë proces do të përfshihen të gjitha kontratat që janë të lidhura nga data 1 janar e vitit 2020. Çfarë ndodh me kontratat që janë lidhur në dhjetor të vitit 2019?

Së dyti, a është bërë ndonjë ushtrim lidhur me kontrata që nuk kanë zbatuar afatet kontraktuale të vendosura për përmbushjen e tyre dhe kryerjen e investimeve? Në rast se është bërë ky ushtrimi, sa për qind e kontratave janë më vonës për arsye të tyre?

Së treti, ju keni përcaktuar një listë me artikuj. Unë doja të dija sa për qind e hekurit që konsumohet në Shqipëri për nevoja ndërtimore dhe më gjerë se kaq prodhohet në vend?

Nëse është bërë një analizë se pse është ngritur çmimi i hekurit, cilat janë arsyet? Të njëjtën pyetje kam edhe për çmimin e çimentos. Sa për qind e çimentos që përdoret dhe përfshihet në punët publike prodhohet në vend dhe cilat janë arsyet e rritjes së çmimit të çimentos? Bitumi është një element tjetër, po sa për qind e bitumit prodhohet në vend dhe konsumohet dhe cila është arsyeja e rritjes së çmimit të tij?

Së fundi në rast se është bërë një ushtrim tjetër a mund të më thoni se sa për qind e këtyre kontratave janë nënkontraktuar? Dhe në rast se janë në kontraktuar me çfarë vlere në raport me vlerën e kontratës janë nënkontraktuar?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zoti Spaho, pastaj zonja Dhima, pastaj zoti Sinaj.

Edmond Spaho – Së pari, do të ndalem te masa e kompensimit, të cilën e përmendi zonja Pranvera, që është 5-30%. Pse nuk bëhet përcaktimi i korigjimit bazuar në të ardhurat, për shembull çimenton do ta kompensojmë me kaq për qind, sepse kaq është indeksi i çmimeve të ndërtimit, ose tubat do t'i kompensojmë me kaq për qind, ose hekurin me kaq për qind, por është lënë një zë i përgjithshëm që ka një diferencë shumë të madhe.

Së dyti, nisur nga shifra 5-30%, pyetja që shtroj unë a është vërtetë inflacioni aq sa na thuhet 6,8%? Me sa di unë indeksi i çmimeve të ndërtimit, që na jepet nga INSTAT-i, nuk është në këto kufij 5-30%, atëherë pse ne i kompensojmë kaq?

Së fundi, nëse këto shifra janë të vërteta dhe i përgjigjen realitetit pse nuk kompensojmë edhe qytetarët me të njëjtën masë, për shembull, çmimin e karburantit pse nuk ia kompensojmë, por i lëmë të paguajnë 2600 lekë të vjetër, kurse firmave të ndërtimit ai kompensojmë një për një?

Antoneta Dhima – Faleminderit!

Duke u nisur nga problematikat që janë evidentuar nga ARRSH-ja, si edhe nga institucionet, të cilat janë duke zbatuar punimet, unë kam një pyetje pasi në aktin normativ dhe në relacionin, i cili shoqëron aktin normativ, ky do të përfshijë vetëm ato subjekte, të cilat kanë kontrata nga 1 janari i vitit 2020. Unë doja të dija sa është numri i kontratave, të cilat janë lidhur me një afat më shumë se një vit buxhetor? A do të përfshihen në këto kontrata, ose a do të kompensohen financiarisht për çmimin e hekurit, për çimenton, bitumin e të tjera të specifikuar në aktin normativ, pasi sipas grafikut të punimeve ata janë duke kryer punime edhe gjatë vitit 2022, të cilat mund të përfundojnë në dhjetor të vitit 2020 ose përtej tij? A do të jenë këto pjesë e këtij akti normativ?

Vullnet Sinaj - Faleminderit!

Në tërësi projektligji flet për çmimet e çimentos, hekurit, tubave plastikë, bakrit, zinkut, kurse në nenin 8 thuhet për kontratat publike për punë që do të lidhen pas hyrjes në fuqi të këtij akti normativ. Autoritet kontraktore duhet t'i referohen çmimeve të tregut për materialet hekur

çimento, bitum, tubave plastikë dhe në rastin e shoqërive me kapital shtetëror të paktën 51% duke përfshirë edhe aluminin bakrin dhe zinkun. Pse keni bërë këtë dallim këtu për aluminin bakrin dhe zinkun? A nuk përfshihet ky kompensim i çmimit për ndërmarrjet që nuk janë me 51 % kapital shtetëror?

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Nëse ndonjë koleg tjetër nuk ka pyetje, mund të vijoni me përgjigjet e pyetjeve.

Faleminderit, zoti Sinaj!

Ilir Bejtja – Pyetja e parë ishte pse 5 deri në 30% kompensim. Jo e gjithë kontrata në zbatim ka vetëm hekur, alumin, çimento dhe bitum, këto janë një pjesë e materialeve që përbëjnë preventivin dhe nga struktura e kontratës që kemi pasur është vlerësuar që efekti i tyre nuk është më shumë sesa e kemi parashikuar në aktin normativ.

Pra, ka kontrata ku ka vetëm një zë, hekur dhe pjesa tjetër janë materiale të tjera, çka do të thotë që rritja e hekurit në total edhe sikur 100% të jetë rritur çmimi, aktualisht është në kufijtë e 44%, nuk ndikon më shumë sesa 5% në totalin e kontratës, siç ka edhe kontrata që kanë më shumë sesa kaq materiale, të cilat përfshihen në aktivin normativ dhe shkojnë në kufijtë e 30% të volumit total të kontratës si punime.

Pyetja e dytë ishte, a ka subjektivitet dhe se si do të vlerësohet. Sa i takon pjesës së subjektivitetit ne flasim me shifra, llogaritje, preventivime dhe pasqyra kostoje, si dhe me procese që kanë të bëjnë me supervizimin dhe me kolaudimin, pra nuk bëhet fjalë që të kemi njerëz, të cilët bëjnë një bandë prej 10 vetash dhe të gjithë bashkë firmosin për të paguar ose fituar para. Ky lloj subjektiviteti ka qenë gjithmonë.

Edmond Spaho – Në fakt, edhe në këtë shqetësim ngritëm, që të mos lihet në një segment kaq të gjerë 5 deri në 30, por sipas zërave të përcaktohet masa e kompensimit sipas indeksit të çmimeve të ndërtimit, i cili llogaritet, sipas inflacionit, pra materialeve të ndërtimit e thënë më shqip. Kjo do të ishte më e ndershme dhe e saktë.

Sa i takon subjektivizimit, ka kaq shumë shembuj si veprohet, kështu që ne kur e ngremë si shqetësim e bëjmë duke u nisur nga praktika, ka ndodhur, ndodh dhe do të ndodhë edhe në të ardhmen. Nuk mund të them që është faji i drejtuesve dhe të them që duhen akuzuar drejtuesit që bëhen pjesë me ta, por ka edhe njerëz të tillë që duan të përfitojnë nga çdo mundësi që u jepet, madje e kanë treguar që përfitojnë, prandaj subjektivizim do të ketë atje.

Ilir Bejtja – Po jua theksoj edhe një herë që vlerësimi bëhet mbi bazën e efekteve që jep secili prej materialeve të përfshira në listë në totalin e kontratës. Subjektivizim nëse mund të shumëzojmë 2 herë 2 dhe të themi që bën 5, nuk besoj që kemi. Siç jua thashë duhen të bëhen bashkë 10 veta dhe të bëjnë një bandë...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, po ju përgjigjem pyetjeve tuaja!

(Diskutime pa mikrofon)

Kjo e gjitha është një gënjeshtër, sepse asnjëherë nuk ka pasur 20 milionë euro për 1 kilometër, këto janë fantazitë tuaja. Ka qenë ura e përfshirë në mes, mbikalimi...

(Diskutime pa mikrofon)

Zotëri, të lutem, a mund të vazhdoj?

Pyetjen ma ka bërë zonja, kur të vijë te pyetjet tuaja mund të vazhdojmë.

Sa është shuma e efektit financiar në rindërtim apo për kontratat e tjera në përgjithësi. Do ta bëjmë një llogaritje të tillë në total dhe do t’jua sjellim si informacion, sepse nuk e kemi këtë shifër. Ne i kemi referuar efektit që kanë pasur këto mallra, në mosfillimin e punës kryesisht, pasi shumë prej kontratave të lidhura gjatë këtij viti kanë qenë tenderuar para datës 1 janar, ndërsa kontratat janë lidhur më pas. Kanë kaluar mbi 5 muaj ku çmimet janë harbuar, janë rritur disa herë dhe askush sot nuk mundet të garantojë që mund t’i marrë të njëjtat produkte siç kanë qenë projektuar më parë me çmimet e sotme, pasi ato ndryshojnë çdo ditë. Kemi pasur raste të rritjes së çmimit edhe me 100%, po marr si shembull hekurin, ndërsa sot e kemi me 44%.

Zotëria afër meje ka një grafik që tregon lëvizjen e çmimit në muaj. Janë mallra burse, pra çmimet e tyre nuk vendosen në Shqipëri...

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Braçe, nuk ka ardhur akoma te pyetjet tuaja.

Ilir Bejtja – Do t’jua them edhe atë.

Do t’jua sigurojmë listën e kontratave ekzistuese të lidhura, që kemi.

Çfarë ka ndodhur me kontratat e lidhura në dhjetor? Në fakt, ndryshimet e çmimeve, për nivelet që jemi duke folur, kanë filluar nga janari e këtej. Nëse do të ketë ndonjë kontratë që është prekur në këtë formë, do ta vlerësojmë dhe do të shohim edhe mënyrën se si do ta akomodojmë, por nëse duhet, mund ta gjejmë një zgjidhje edhe në këtë akt normativ.

Erion Braçe – Nga janari i kujt viti?

Iir Bejtja – Nga janari i këtij viti.

Erion Braçe – Ju thoni për janarin e 2020?

Iir Bejtja – Unë po diskutoj për kontratat e lidhura, ndërsa për kontratat e reja nuk kemi shumë të tilla.

Erion Braçe - Qëllimi i pyetjeve që ju bëra ishte pikërisht koha. Pra, nëse ne fillojmë të paguajmë kontrata nga data 1 janar e vitit 2020, kur çmimet, siç edhe ju thoni, kanë filluar të rriten më 1 janar 2022, atëherë dua të di gjithçka që kam pyetur më pas. Kur i referohem kohës kam parasysh pyetjen që bëra, sa nga këto kontrata për të cilat ju flisni janë me vonesë në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale? Janë në vonesë me afatet, janë në vonesë me bërjen e një ure, të një rruge e kështu me radhë.

Iir Bejtja – Po flasim për kontrata që nuk kanë filluar për shkak të rritjes së çmimeve dhe që zgjasin në procedura prokurimi. Po ju marr si shembull 400 kilovoltëshin me Maqedoninë e Veriut, është tenderuar në mars të vitit 2020, është lidhur kontrata në dhjetor të 2020-s, në 2021-in presupozohej që duhej të fillonin punimet, por është vonuar nisja e punimeve nga ana e palës maqedonase dhe në gusht të 2021-t ka filluar inaugurimi i punimeve në Ohër. Nga ky moment që të gjitha çmimet kanë filluar rritjen dhe të tre kontraktorët, si ata që kanë nënstationet, por edhe ata që kanë 2 lotet e linjave, kanë stopuar punën. Për këtë arsye është bërë kërkesa edhe në APP...

(Diskutime pa mikrofon)

Po për këto tip kontratash jam duke folur...

Erion Braçe – Po jo për këto tip kontratash...

Iir Bejtja - ...që janë të pezulluara.

Erion Braçe – Iir, ky është rasti i kontratës fatkeqe. Këtu në ligj flisni për tjetër gjë. Në ligj thuhet: “...procesit të rindërtimit apo të enteve të tjera publike, të cilat janë në proces për t’u lidhur përpara hyrjes në fuqi të këtij akti normativ ose në proces zbatimi nga data 1 janar 2020”. Një shkollë...

(Diskutime pa mikrofon)

Iir Bejtja – Ka mbaruar një shkollë.

(Diskutime pa mikrofon)

Erion Braçe - Prit pak, sepse pikërisht për këtë arsye ju pyeta: a keni një listë të kontratave, sepse nuk mund të diskutojmë në tym. Pse? Unë di që ka shkolla që nuk kanë

mbaruar. Ky afat kohor kaq i gjatë pa bërë analizë nëse kjo kontratë është në afat apo nuk është, krijon mundësi për spekulim për sa kohë që çmimet kanë filluar të rriten në 1 janar të 2022, siç thoni ju.

Ilir Bejtja – Mund të bëni një propozim se si mund të amendohet, por për mua, që tani mund të përjashtohen kontratat, të cilat janë jashtë afatit.

Erion Braçe – Ky ka filluar të zbatohet.

Ilir Bejtja – Nuk ka filluar të zbatohet. Si ka filluar të zbatohet?

Erion Braçe – Ka hyrë në fuqi akti normativ.

Ilir Bejtja – Është në diskrecionin tonë dhe tuajin ta verifikojmë, t’ju sjellim informacionin, si dhe t’ju themi që kontratat me vonesë që janë jashtë afatit janë duke paguar penalitete, nuk janë të mbështetura dhe as do të mbështeten.

Erion Braçe – Nuk e di, por më duhet ta shoh.

Ilir Bejtja – Pyetja tjetër është sa prej këtyre materialeve prodhohen në vend, kryesisht bitumi, hekuri dhe çimentoja edhe pse çmimi është rritur. Në të tre rastet është rritur çmimi i energjisë, në prodhimin e hekurit është rritur direkt energjia elektrike dhe prodhuesi ynë i hekurit e merr energjinë në tregun e lirë, pra nuk furnizohet...

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk e di duhet ta marr, por është efekt për t’u marr.

Erion Braçe – Pyetja që unë kisha ishte: a është bërë një ushtrim mbi këto kontrata apo jo?

Ilir Bejtja – A mund të vazhdoj?

Erion Braçe – Ne vazhdojmë me teorinë që çmimi i hekurit caktohet në bursë...

Ilir Bejtja – Po, caktohet në burës.

(Diskutime pa mikrofon)

Ne nuk kemi ndonjë ligj që t’i ndalojë kompanitë shqiptare t’i shesin produktet me çmime të detyruara, por duhet t’i shesin me çmimet e bursës.

Erion Braçe – Unë atëherë po u bëj thirrje të gjithë bujqve që ta shesin grurin me çmimin e bursës.

Ilir Bejtja – Duhet ta shesin me çmimin e bursës.

(Diskutime pa mikrofon)

Po nuk e shesin dot se është më lirë gruri në bursë sesa në Shqipëri.

Erion Braçe – Ashtu është. Për hekurin si është?

Ilir Bejtja – Në tregun ndërkombëtar?

Erion Braçe – Hekuri që prodhohet në Shqipëri si është, është më i lirë apo më i shtrenjtë sesa në bursë?

Ilir Bejtja – Me çmim burse, shitet me çmim burse.

(Diskutime pa mikrofon)

Është thirrje e madhe për të gjithë botën nuk është vetëm për ne.

Edmond Spaho – A po thoni që çmimi në bursë është më i ulët?

Ilir Bejtja – Unë e kam ndjekur edhe debatin e zotit Braçe dhe jam shumë dakord që çmimi i grurit duhet ngritur...

(Diskutime pa mikrofon)

Duhet ta ngrenë çmimin që të justifikojnë kostot e tyre, por sot nuk jemi për këtë punë. Unë nuk mbuloj sektorët e grurit.

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk jam unë, ju jeni, por nuk jam unë.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju jeni për grurin, por nuk jam unë.

Edmond Spaho – E kuptoj edhe gjuhën e arrogancës me të cilën flisni për një çështje kaq të rëndësishme.

Ilir Bejtja – Unë nuk jam arrogant, nuk kam qenë ndonjëherë, veçanërisht me ju.

Edhe sa i takon pyetjes sa për qind të kontratave janë të nënkontratuara dhe me çfarë vlere, do t’jua sjellim me informacion.

Zoti Spaho ka bërë pyetjen, masa e kompensimit deri në 30%. Besoj se e dhashë përgjigjen për këtë, por mund të jetë edhe ajo që thatë ju, megjithatë kjo bazohet, nëse e lexoni të plotë nenin 6, pikërisht në ndikimin e secilit prej materialeve në totalin e vlerës, prandaj edhe vlera luhetet nga 5 deri në 30%, sepse jo në çdo kontratë ndodhen të gjashtë materialet.

Për inflacionin nuk kam informacion, por nëse e doni duhet t’ia kërkojmë Bankës së Shqipërisë.

Sa i takon pyetjes, pse qytetarët kompensohen ndërsa firmat jo, më duhet t’ju them që kemi bërë një kompensim goxha të gjerë me një paketë të dytë për përballimin e krizës, ku ne u jemi referuar pensioneve, pagave, indeksimeve, pra të gjitha elementeve që sot ndikojnë në

tregun e konsumit të mallrave direkt mbi qytetarët. Megjithatë, zonja Xhemali mund t'ju përgjigjet më saktë.

Zonja Dhima, ka bërë pyetjen, sa është numri i kontratave të lidhura më shumë se 1 vit. Ka shumë të tilla, pasi të gjitha kontratat që janë me vlera të mëdha janë më shumë sesa 1 vit buxhetor dhe do të vazhdojnë derisa qeveria të verifikojë dhe të vendosë që situata e veçantë ka përfunduar.

Zoti Sinaj, në pyetjen e tij i referohet nenit 8, pika 1, ndërmarrjet që kanë më pak se 51% kapital. Janë mbi 51% kapital shtetëror.

Vullnet Sinaj – Në tërësi projektligji flet për çmimet e hekurit, çimentos, zinkut dhe të bakrit, ndërsa te ky nen ndahet. Në të thuhet: “Autoritetet kontraktore duhet t’u referohen çmimeve të tregut për materialet hekur, çimento, bitum dhe tuba plastikë. Në rastin e shoqërive me kapital shtetëror të paktën 51%, duke përfshirë edhe aluminin, bakrin dhe zinkun”. Pse është bërë ky përjashtim? Pse për zinkun, aluminin dhe bakrin kemi të bëjmë me çmime vetëm për ndërmarrjet që janë të paktën me kapital 51% shtetëror apo për të gjitha? Kjo ishte pyetja ime.

Ilir Bejtja - Do t’ju jap një interpretim timin, për informacionin që kam. Akti është iniciuar si fillim nga vështirësitë që ka pasur në lidhjen e kontratave, jo një ndërmarrje publike, por ARRSH-ja, ndërsa më pas është shtuar edhe pjesa e ndërmarrjeve publike me 51%, ku përfshihet OST-ja dhe ndonjë kompani tjetër si porti ose hekurudha, të cilat përdorin këto materiale për linja, kablllo, izolatorë. Kjo është referenca.

(Diskutime pa mikrofon)

Në përgjithësi jo në vlerë, sepse po diskutojmë për ndërmarrjet publike.

Eduard Shalsi – Zonja Xhemali, do të shtoni ndonjë gjë? Jo.

Zonja Dhëmbi, fjala për ju.

Mimoza Dhëmbi – Meqë u krijua pak konfuzion në lidhje me mënyrën e kompensimit, dua t’ju shpjegoj mënyrën se si e kemi konceptuar në aktin normativ dhe procedurën e detajuar të kompensimit. Ideja është që kompensimi do të trajtohet si kontratë shtesë për kontratat ekzistuese që janë në zbatim dhe do të përfshijë vetëm vlerësimin e punimeve që fillojnë nga dita që miratohet akti normativ deri në fund të vitit.

Pra, kur formulohet kontrata shtesë, në bazë të kërkesës së kontraktorit bëhet një vlerësim i kostos që zënë këto elemente që janë përcaktuar këtu të ndara për institucionet buxhetore dhe për kompanitë shtetërore, bëhet një vlerësim i çmimeve të tregut të momentit, hidhet kontrata

shtesë dhe pagesat bëhen kundrejt situacioneve konkrete. Pra, në situacion do të shihet konkretisht çmimi dhe fatura e blerjes së materialit, merret çmimi në ditën që ai ka blerë materialin, por gjithmonë nuk kompensohet më shumë se 30%. Nëse çmimi që ka blerë materialin është rritur me 60%, supozojmë çimentoja, nga preventivi që ai ka pasur kur ka lidhur kontratën kompensohet deri në 30%. Merren të gjithë elementet një për një dhe shikohet konkretisht çmimi në faturë që është pjesë e situacionit të punimeve, pra nuk ka një mesatarizim, një indeksim, por merret çmim për çmim dhe asnjë çmim nuk kompensohet më shumë se 30%, ndërkohë që çmimi mund të jetë rritur edhe 100%. Tavani është vendosur, po pse është vendosur 5 deri në 30%. Sepse deri në 5% nuk kompensohesh, në qoftë se çmimet janë rritur deri në 5% ato janë pjesë që mund të absorbohen brenda kontratës, ka fond rezervë, është fitimi i kompanisë e të tjera. Çdo çmim që është rritur mbi 5%, por jo më shumë se 30%, kompensohet deri në këtë masë, pavarësisht sesa është çmimi; çmimi do të vërtetohet sa është blerë, sa është në situacion, do të kontrollohet situacioni konkret.

Pra, është lidhur kontrata në përgjithësi me një çmim të vlerësuar, por jo më shumë se 30% dhe kur ta marrë kompensimin, kundrejt kësaj kontrate shtesë, do të shihet çmimi konkret se sa e ka blerë një nga këto elemente që janë parashikuar në këtë akt normativ. Është e qartë skema? Bëhet fjalë për kontrata që janë të lidhura që nga 1 janari i vitit 2020, por kjo nuk do të thotë që të marrë kompensim për punë të kryera më parë se dalja e aktit. Është nga sot e tutje. Ky është koncepti.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ato që janë të përfunduara, kanë mbaruar, por edhe ato që janë në proces, por janë lidhur që nga viti 2020, marrin vetëm për punën që kryejnë sot e tutje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Erion Braçe – Ju thoni se kontrata ka filluar të zbatohet në datën 1 janar 2020, është me vonesë dhe vonesën ju nuk e njihni për penalitet, por e njihni edhe për t’u paguar këtu, në nenin 8, “Dispozitat kalimtare”, në pikën 2, dhe ka ngelur me 50% të punimeve, pavarësisht se është me vonesë jokontraktuale e të tjera me radhë, dhe këtë 50%-in e punimeve do t’ia kompensojë, se ky e ka lënë për datën 18.05 e këtej. Kështu i bie?

Ilir Bejtja - Ndërprerja e punimeve bëhet e qartë nga momenti i rritjes së çmimeve....

Erion Braçe – Ku thuhet kjo gjë?

Ilir Bejtja - Është e verifikueshme, ne po diskutojmë vetëm për rritjen e çmimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po është me tre lote, katër lote dhe ecën. Është 3 vjet, 4 vjet një kontratë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për pjesën e punimeve, që i takojnë kësaj periudhe, ai përfiton nga ndryshimi i çmimeve në treg.

Nuk po diskutojmë për vonesat. Ne nuk po u njohim vonesën, po u njohim pjesën e efektit të çmimeve për këtë periudhë, kur ato janë rritur, për punimet e kontraktuara për t'u bërë në këtë periudhë.

Eduard Shalsi – Edhe shpjegimet e Mozës, edhe shpjegimet tuaja po hedhin dritë te disa pikëpyetje, që kishin kolegët deputetë.

Këto që ju shpjeguat verbalisht në tekstin e aktit normativ, pra ndërhyrjet tuaja të fundit dhanë një garanci për pikëpyetjet e kolegëve deputetë. Çështja është që këto përgjigjet që dhatë ju verbalisht në tekstin e aktit normativ, janë të garantuara, apo jo? Kjo është pyetja që kanë.

Ilir Bejtja - Qeveria ka shpallur një situatë të veçantë dhe kjo ka një datë kur është shpallur. Ne nuk kemi sjellë vetëm këtë akt normativ, i cili prek situatën e veçantë, por edhe 5, 8, 9 dhe ky është 10-ta. Në këto akte normative u referohemi vetëm periudhave dhe kontratave, efekteve që kemi në këtë periudhë. Nëse ai është në vonesë, është në penalitet, nuk ka lidhje fare me këtë, po diskutojmë për kontrata pa penalitet.

Erion Braçe – Më vjen shumë keq, Ilir!

E ke në nenin 8, pika 2: “Vonesat në zbatimin e kontratave publike, për të cilat shtrin efektet ky akt normativ, si dhe vonesat në zbatimin e kontratave në kuadër të procesit të rindërtimit, që janë në proces zbatimi nga data 1 janar 2020, nuk do të konsiderohen si shkelje e kushteve kontraktore dhe nuk do të aplikohen penalitete ndaj operatorëve ekonomikë”. Pra, ti po i paguan këto, ti i amniston dhe i paguan.

Eduard Shalsi – Zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Për nenin 8, pika 2, edhe pse nuk kemi kaluar në shqyrtimin nen për nen, unë kam sugjerimet e mia, ku thuhet: Vonesat për zbatimin e kontratave publike, për të cilat shtrin efektet ky akt normativ, si dhe vonesat në zbatimin e kontratave në kuadër të procesit të rindërtimit, që janë në proces zbatimi nga data 1 janar 2020, nuk do të konsiderohen si shkelje e kushteve kontraktore dhe nuk do të aplikohen penalitete ndaj operatorëve ekonomikë”, pikërisht këtu do të doja të bëja një amendim, sepse duke u thënë kështu, duket sikur këta justifikojnë edhe

vonesat e mëparshme. Në rast se ne e bëjmë këtë pikë kështu: “Vonesat për zbatimin e kontratave publike, për të cilat shtrin efektet ky akt normativ, si dhe vonesat në zbatimin e kontratave në kuadër të procesit të rindërtimit, që janë në proces zbatimi nga data 1 janar 2020...”, po të shtojmë:” të cilat kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij akti normativ” merr kuptim neni 2 dhe ata nuk justifikohen për vonesat që kanë sjellë më parë. Pra, nga dalja e aktit dhe këtij.

E kisha si sugjerim për ta bërë kur të shkojmë te neni.

Ilir Bejtja - Kemi kontrata, siç ju thashë, 400-kilovoltëshe me Maqedoninë që nuk kanë filluar fare dhe janë nënshkruar në nëntor 2020. Ka filluar inaugurimi i punimeve në Ohër të Maqedonisë në gusht 2021...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne këtyre u referohemi, kontrata që...

Eduard Shalsi – Pra, informacioni për çfarë kontratash afektohen, do ta zbuste shumë debatin, sepse askush nuk po vë në dyshim këtë që thatë ju, pra nuk ka pikëpyetje për këtë, pikëpyetje ka për kontrata të tjera. Kjo do të thotë se informacioni për kontratat është shumë i rëndësishëm për të parë se kush përfiton. E gjithë ideja është që nga ky proces të mos përfitojnë kompanitë abuzive apo kompani, të cilat shfrytëzojnë momentin dhe, nën pretekstin e ngritjes së çmimeve, justifikojnë vonesat për kontrata të ndryshme. Ky është shqetësimi që kanë deputetët.

Në parim nuk kemi asgjë kundër kompensimit për çmimet e rritura, në praktikë është si do të realizohet, dhe kjo është pikëpyetja, monitorimi dhe cilët janë përfituesit e kontratave, duke dashur të shmangim kompanitë.

Ilir Bejtja - Mund t’ia bashkëngjisim listën si aneks.

Eduard Shalsi – Nga pikëpamja e teknikës legjislative nuk mund të ndërhyhet, por ajo që do ta zgjidhte çështjen deri diku është transparenca e kontratave, që përfitojnë nga një akt normativ i tillë. Nga pikëpamja teknike, së pari, duhet të vendosen në dispozicion këto kontrata. A mund të vendosen që sot në dispozicion?

Atëherë, duke na vendosur kontratat që sot në dispozicion, që është e martë, të enjten kemi për shqyrtim në seancë parlamentare aktin normativ, mbi bazën e informacionit që do të na vendosni, duhet të monitorojmë kontratat dhe, në zbatim të aktit normativ, pastaj, aty do të jetë një vigjilencë shumë e madhe për të parë cilat janë kontratat që mund të jenë subjekt apo objekt abuzivizmi, duke përjashtuar këtë që ju përmendët për 400-kilovoltëshin, nuk është ky qëllimi. Pra, lista dhe përfituesit e kontratave e ndarë sipas objekteve, është shumë e rëndësishme të

ndahet kjo sipas objekteve, informacioni duhet shpjeguar thjeshtë, në mënyrë që të përqendrohen te shqetësimet që kanë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka diçka këtu, Moza, natyrisht që për këtë akt janë bërë disa kalkulime. Nëse informacioni nuk është 100%, por është 98% apo 90% nuk ka problem, çështja është që, e para, janë bërë kalkulime, sepse kjo është kosto dhe do të rëndojë buxhetin e shtetit, që do të thotë se ne duhet ta dimë sa do të jetë vlera. Duke na vënë në dispozicion tipologjitë dhe kontratat, pra 40% pushteti vendor, 60% pushteti qendror, te përqindja e pushtetit qendror janë kaç kontrata rrugësh, kaç kontrata shkollash e të tjera; te tipologjia e pushtetit vendor, sepse edhe aty duhet monitoruar situata, mbi bazën e një informacioni të tillë, të shpjeguar thjesht, ne mund të gjurmojmë për t'i parë të gjitha këto shqetësime, pra kjo është ideja. Nuk ka nevojë të hamendësohet, por besoj duhet të jetë bërë një ushtrim i tillë pa të cilin nuk dimë për çfarë akti bëhet fjalë pastaj. Ky është merak.

Kishe diçka për të shtuar, Moza?

Mimoza Dhëmbi - Kjo është bërë e përafërt, edhe me pesha specifike, shumë mesatarizuese, se nuk e dimë, do të përdorë hekur, apo do të përdorë çimento.

Eduard Shalsi – Ama tipologjinë e kontratave duhet ta kemi, apo jo? Kështu që atë na vendosni në dispozicion.

Edhe diçka tjetër, është akt noterial, është miratuar dhe duhet të kalojnë 45 ditë.

Zonja relatore, bashkë me shërbimet e Kuvendit, mbaji shënim kërkesat, në mënyrë që këtë proces ta ndjekim në vijimësi.

Zoti Braçe.

Erion Braçe – Faleminderit, për përgjigjet, edhe për materialet që do të vijnë, por unë dua të them disa fjalë.

E para, këto janë kantiere pune, për sa kohë që janë kantiere pune, qeveria ka ndërmarrë një akt shumë pozitiv për të mos lënë kantieret e punës në mes jo vetëm si vepra publike që kanë shumë rëndësi, veçanërisht ato të infrastrukturës, shkollat, ujësjellës-kanalizime, rrugë, ura, rindërtimi e të tjera, por mbajnë në punë njerëz. Në qoftë se mbyllen këto kantiere apo nuk financohen, masat e atyre që shkojnë për ndihmë ekonomike do të rritet në mënyrë eksponenciare.

Kështu që, është shumë e rëndësishme që të mbështetet një nismë e qeverisë pikërisht për t'i financuar deri në fund kantieret që kanë mbetur në mes, por në krahun tjetër, kini parasysh, që është një nismë sa ekonomike, sociale, gjithashtu, por kthehet edhe në politikë, sepse atje matanë, janë të tjerë njerëz që janë goditur nga vala e tretë e goditjeve të ekonomisë shqiptare. Pra, janë edhe pensionistët, edhe shtresat në nevojë, edhe të varfrit dhe të tjera kategori që kanë nevojë për ndihmë.

Pikërisht, për këtë arsye, ka një rëndësi jetike transparenca për faturat që do të paguajnë

Pa më të voglin diskutim që aktet normativ, sipas legjislacionit në fuqi, nuk i bëhen ndryshime as këtu askund tjetër, por ama një akt, në zbatim të këtij akti, duhet ta detyrojë qeverinë që t'i definojë deri në fund të gjitha problematikat që lidhen me transparencën e kontratave, por edhe problematika të tjera që lidhen me vet natyrën e zbatimit të kontratave.

Ai shembulli që ju sillni për linjën e Maqedoni-Tiranë, është shembulli fatlum që duhet të paguhet me çdo kusht, por ka shembuj të tjerë pastaj, që nuk justifikohen për t'u paguar.

E dyta, që ka po kaq rëndësi, për mua, të paktën, ky akt ilegalizon rritjen e çmimeve praktikisht. Sa kohë që bën këtë gjë, ka shumë rëndësi edhe koha, por ka shumë rëndësi edhe sa është kjo rritje çmimesh që ne do të legalizojmë. Pastaj, problematikat që kemi me tregun, i dimë, i kemi pranuar botërisht. Unë vazhdoj ta them që ne në shumicën dërrmuese të tregjeve edhe të lëndëve të para, siç është hekuri, çimentoja jo vetëm që kemi një përqendrim, por kemi edhe abuzim në to.

Në këtë pikë, unë do të doja që ai akti që do të dalë në zbatim për ta definuar deri në fund këtë akt normativ duhet të ketë pika reference. Në qoftë se ne do t'i referohemi çmimeve të hekurit, kujt indeksi do t'i referohemi, atij të INSTAT-it? Unë nuk kam bursën, zotëri, por kam INSTAT-in që më tregon rritjen e çmimeve. Për këtë po flas.

Unë e mendoj kështu, ju e mendoni ndryshe. Tregu është dinamik, ka brenda edhe dinamikën e luftës, ka brenda edhe dinamikën e spekulimit. Apo jo?

E dyta, prapë te çmimi apo tek ajo që do të paguajmë ne në kontratë, duhet bërë ushtrimi dhe duhet definuar në një akt tjetër që shoqëron këtë aktin normativ. Çfarë peshe të asaj kontrate zë ky produkt? Duhet bërë llogaria deri në fund. Është shumë e rëndësishme kjo gjë, sepse, me thënë të drejtën, qoftë kompanitë e hekurit, qoftë kompanitë e çimentos apo të bitumit që prodhojnë bitumin në vend, kanë qenë në treg të lirë të energjisë elektrike prej dy vitesh. Është

kështu? Atëherë, çfarë bëri vaki që bitumi që prodhohet në vend shkon e rritet me dy herë brenda një periudhe 2-mujore?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nafta, ku? Nafta në Bankers?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, shqetësimi që kam është ky: pika e referencës për rritjen e çmimeve dhe e dyta, masa që zë në vlerën e investimit në faturën që ne do të paguajmë.

Të vijmë te çështjet që unë i konsideroj themelore: e para, është koha dhe vazhdoj të insistoj, sidomos për procesin e rindërtimit.

Vazhdoj të insistoj te pika 2 e nenit 8. Unë mendoj se në qoftë ka tejkalime në afate të pajustificuara, pika 2 e nenit 8 nuk duhet të funksionojë. Nuk kanë pse paguajnë taksapaguesit shqiptarë koston e kompanive që mezi mobilizohen, që duan të bëjnë punën me 10 punëtorë, jo me 20 saç ka nevojë puna që duan e bredhin lart e poshtë për të gjetur çmimin më të lirë të produkteve të tyre e në fund fare nuk e gjejnë dhe humbin kohë, apo që kanë marrë nga 10, 15, 20 punë dhe në një kontratë vonohen pikërisht se nuk kanë kapacitete financiare për t'iu përgjigjur punës që kanë në këtë kontratë. Ndaj e kërkoj unë këtë akt, në zbatim të aktit normativ. Kjo është e para.

E dyta, kompani që kanë nënkontraktuar kontratën 1 herë apo dy herë, e kanë çuar në dorë të tretë, nuk ka pse të paguajë taksapaguesi shqiptar, sepse ajo kontratë paska pasur para në mënyrë konsistente, sa kohë ka vajtur te dora e tretë dhe atje ka fitim, nuk kam pse paguaj unë për ta.

E treta, që është akoma më e rëndësishme, kompani që kanë fituar kontratën me 90% të vlerës së fondit limit e lart, nuk kam pse i paguaj unë, Ilir. Unë vihem në vështirësi për kompani që kanë hyrë, ku konkurrenca ka qenë efektive dhe kanë fituar me 70, 75 apo 80% të fondit limit, por atje do të paguajnë, por unë nuk kam pse paguaj tek ai që ka fituar me 99% të vlerës, pastaj e kam marrë dhe e kam rikontraktuar deri në dorë të tretë.

E fundit që kërkoj, po prapë nga ai akti që duhet të shoqërojë aktin normativ, ky marzhi 5-30% si do të zbatohet?

Jam i paqartë akoma, Ilir, sepse, në qoftë se unë e kam fituar kontratën me 90, 92, 95, 99% të vlerës, do të vij unë të kërkoj 30% tani, se çmimi i hekurit në muajin mars është rritur dyfish apo dy herë e gjysmë si çmim? Duhet ta marr unë këtë? Jo. Unë mendoj se kjo është e

padrejtë, prandaj duhet një akt tjetër shumë specifik, teknik që justifikon apo i jep përgjigje definitive gjitha problematikave që ju mund t'i hasni gjatë zbatimit.

E fundit, duke mbështetur edhe njëherë iniciativën e qeverisë për t'i mbajtur hapur kantieret dhe për t'i mbyllur kantieret deri në fund, me qëllim që ne të përfitojmë veprat, por të përfitojmë edhe punësimin e njerëzve, pa më të voglin diskutim, një shqetësim e kam apo dy, por njëri është themelor. Vlera e hekurit do të paguhet, vlera e çimentos do të paguhet, vlera e bitumit do të paguhet, vlera e tubave gjithfarësh, telave gjithfarësh do të paguhet. Po vlera e krahut të punës, a do të paguhet apo do të ngelet sa ç'ishte në fillim të vitit 2020? Do të paguhet edhe kjo, sepse këtu nuk thuhet asnjë gjë për punëtorët, nuk thuhet asnjë gjë, edhe pse çmimi për orë punë është rritur, këtu nuk thuhet gjë.

Lidhur me këtë, unë mezi pres paketën e dytë, për të cilën folët ju, për shtresat në nevojë, për ta varfrit dhe për punëtorët. Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Braçe!

Urdhëroni, zoti Xhelili!

Alban Xhelili – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit edhe përfaqësuesve të ministrisë!

Të them të drejtën, unë mendoj se akti në tërësi ishte i orientuar mirë dhe për sa u përket kontratave, që u paraqitën, edhe me kërkesën që të na vijjnë, unë nuk jam kundër, por nuk mendoj se do të kemi ndonjë efekt nga pasja e tyre. E vetmja gjë që unë mendoj te akti normativ, që më duket pak si shenjë amnistie, është gjithmonë se i referoheni nenit 8, pika 2, ku thuhet “të gjitha vonesat në zbatim të kontratave, pa përcaktuar këtu për faj të kujt nuk do të aplikohen penaltete për operatorët ekonomikë. Pra, kjo pjesa e mosaplikimit të penalteteve nuk më duket e drejtë. Patjetër që këta duhet të përfitojnë nga pjesa e kompensimit, sepse efekti negativ do të ishte më i madh, në qoftë se nuk do të përfitonin, por nuk ka pse të përjashtohen nga penaltetet, në qoftë se problematika në vonesën e kontratave do të ishin për faj të tyre.

Për pjesën tjetër jam shumë dakord. Faleminderit, për prezantimin!

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Denaj!

Anila Denaj – Faleminderit për diskutimet dhe për përgjigjet!

Për të qenë konkretë për çështjet që u ngritën nga kolegët, do të ishte e nevojshme që të rritim nivelin e transparencës. Kam dy sugjerime, ose Ministria e Financës të vendosë një

platformë mujore komunikimi në faqen e internetit, sikurse edhe informacion për parlamentin për vendimet që merr ose, në bazë tremujore, të sillt një raportim në parlament për të gjitha këto çështje, të cilat ngelën të hapura dhe, meqenëse akti normativ nuk i përmirëson dot, por, duke marrë në funksion të objektivit qëllimin e mirë për të mbështetur gjithë këtë proces, duhet të rrisim transparencën.

Kjo është në predispozicionin e Ministrisë së Financave, sepse nuk duam të shtojmë punë administrative, por qytetarët dhe komisioni ka nevojë të dinë më shumë për këto dy çështje që mbeten hapur, pra të dinë se cilët janë përfituesit dhe hapësira 5 deri në 30 vjet të jetë brenda objektivit që ka qeveria për mbështetje dhe jo për të lejuar spekulime. Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Denaj!

Urdhëroni, zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Në fakt, në nenin 2, që i përket fushës së zbatimit të këtij akti normativ, në pikën 8 të tij, theksohet se në rast të përfundimit të situatës së veçantë, e cila përcaktohet me VKM, me propozim të ministrit të Financave dhe njëkohësisht të Infrastrukturës, fondi i papërdorur nga shtesa e kontratës, mbetet në buxhetin e autoritetit kontraktor.

Dua t'i sjell në vëmendje Ministrisë së Financave që duhet të jetë e vëmendshme, sepse mund të ndodhë që kërkesa e autoritetit kontraktor nuk mund të merret në konsideratë dhe mund t'i refuzohet kërkesa operatorit ekonomik dhe ai ka të drejtë të bëjë ankimimin në gjykatën kompetente. Kjo procedurë mund të zgjasë tej datës 31 dhjetor dhe në miratimin e buxhetit duhet të kihet parasysh që këto fonde t'u lihen në dispozicion autoriteteve kontraktore për të bërë shlyerjen e këtyre detyrimeve. Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zoti Spaho!

Edmond Spaho – Unë nuk them që ky problem nuk ekziston. Ekziston dhe duhet zgjidhur, por zgjidhja duhet të jetë e drejtë, transparente, njëkohësisht, të marrë parasysh edhe pasojat që vuajnë grupe të tjera të shoqërisë. Prandaj insistova që akti normativ duhet të jetë shumë i saktë, i qartë në procedura, në metodikën se si do të bëhet kompensimi, në mënyrë që të mos abuzohet. Mundësi për abuzim ka pa fund.

Fakti që normat lihen në një diapazon kaq të gjerë, 5-30%, është një mundësi që gjatë zbatimit të aktit normativ të përfitojnë edhe njerëz, të cilëve nuk u takon të përfitojnë. Për shembull, nuk jam dakord që kontratat, të cilat e kanë kaluar afatin e realizimit, të kompensohen. Paraprakisht, duhej të ishte bërë një analizë e këtyre kontratave dhe të përcaktohej se e ç'loj

natyre duhej të ishin kontratat, të cilat do të duheshin të kompensoheshin. Duke e lënë të hapur mundësinë, të jeni të sigurt që ata, të cilët janë më pak korrektë, që përfitojmë më shumë në kurriz të të tjerëve, do të përfitojnë edhe nga akti normativ.

Praktika e ka treguar që ata dinë t'i gjejnë rrugët si të hyjnë, ta bindin administratën dhe të përfitojnë edhe nga akti normativ.

Së dyti, që e ngriti me shumë të drejtë zoti Braçe, këtu është një praktikë që jepet kontrata, pastaj dalin nja dy-tre palë nënktraktorësh. E merr i dyti, i dyti ia jep të tretit, i tretit të katërtit e katandiset kokoshi një thellë. Konstatimi që fondet janë të dhëna, të saktë për të kryer atë punë, është i drejtë. Atëherë, pse duhet ne të kompensojmë përfitimet që kanë marrë nënktraktorët njëri pas tjetrit? Kjo nuk është normale.

E fundit, që e ngriti zoti Braçe, ata të cilët kanë marrë kontrata me 99% të vlerës së tenderit, 98, 99, si janë shumica e kontratave këtu te ne, por ne duhet t'u ofrojmë privilegjin që të kompensohen.

Këtu desha të ngre edhe një çështje tjetër, që ka të bëjë në tërësi me qeverinë, që ka një mospërputhje rritja e çmimit në praktikë ose mundësia që i japim ne për ta kompensuar me çfarë gjen në realitet. INSTAT-i thotë që çmimi i karburantit është rritur kaq për qind, që është nën 10%, por, në fakt, kur shikojmë çmimin që na vë bordi, tregon një rritje skandalozisht të lartë. Atëherë, kush gënjen në këtë rast? O gënjen INSTAT-i, o gënjen bordi.

E njëjta gjë për çmimet e ndërtimit. Ka indekse që publikohen muaj për muaj. Indekset nuk thonë 30%. Atëherë, o gënjen INSTAT-i, o gënjen qeveria. Mendoj se këto janë çështje që duhen të trajtohen me shumë seriozitet, sepse kemi të bëjmë me para publike. Për më tepër, sikurse, me të drejtë, e ngriti kolegu, shtresat e tjera, pavarësisht sa themi ne, nuk po marrin asgjë, pensionistët, të varfrit, të papunët. Kështu që nuk jemi aq të pasur, sa paratë t'i lëshojmë varda, në një kohë që pjesë shumë të rëndësishme të popullsisë vuajnë dhe heqin picirin për të përballuar jetën.

Eduard Shalsi – Këtu na hape debate tani, se sot duhet t'i hapin përgjigje zotit Spaho për të gjitha shtresat.

Zoti Bejtja, një përmbledhje, ju lutem!

Ilir Bejtja – Unë do ta filloj nga ajo që kemi ne nevojë tani. Na duhen minutat e kësaj mbledhjeje të zbardhuara që të marrim parasysh një për një çdo element që u ngit këtu gjatë debatit, ndoshta për një akt të ri normativ më të thelluar ose akt nënligjor për zbatim.

(Ndërhyrje nga salla)

Gjithsesi, ju duhet ta dini këtë, prandaj po them që do t'i marrin të gjitha këto, duke ju falënderuar, kuptohet. Dua t'ju garantoj që akti është nisur në urgjencë nga nevoja për vazhdimin e marrëdhënieve që ne kemi me kontraktorët për të gjitha kontratat e lidhura dhe nuk ka qenë për të akomoduar askënd. Ligji nuk rregullohet nga ky akt normativ, çon para drejtësisë të gjithë ata që organizohen ose individualisht kryejnë akte kriminale për të shmangur apo përn të evituar ligjin dhe për të përfituar për veten e tyre.

Pra, ky akt normativ nuk e rregullon atë marrëdhënie, zoti Spaho.

Nga ana tjetër, i referohemi një segmenti, i cili nuk prek në mënyrë të drejtpërdrejtë me çmime, sepse nuk flasim për kontrata që realizojmë produkt që shkon te konsumatori final, por flasim për kontrata infrastrukturore dhe logjistike në zinxhirin e madh të vlerës së një ekonomie, të cilat kanë të bëjnë me rrugë, kanë të bëjnë me linja, kanë të bëjnë me ndërtesa, me logjistikë, gjëra të cilat ne i kemi në vazhdim dhe janë pjesë e infrastrukturës publike që ne kemi dhe jo detyrimisht japin efekte direkte në çmime në tregun fundor, përkundrazi, japin produkte publike për tregun fundor.

Pra, të ndërtohet një spital të ri, do të thotë të shtosh shtretërit dhe kapacitetin, jo të rrisësh koston e jetesës së punonjësve, përkundrazi, pikërisht që këto kontrata të zbatohen, ndoshta do të duhet bërë edhe ajo që thotë zoti Braçe, të rishikohet edhe mundësia e rritjes me të njëjtën logjikë të zërave që i takojnë krahut të punës, duke filluar nga pagat deri te sigurimet e të tjera me radhë.

Sa i takon aktit të parë normativ, e theksoj, meqenëse edhe zoti Shalsi e kishte me merak, për pjesën e mbështetjes së shtresave në nevojë, ka qenë një paketë më se e plotë, duke përfshirë brenda jo vetëm atë që është livruar në para direkte për grupet vulnerabël, për konsumatorët në nevojë në treg, por edhe atë çfarë ne kemi bërë që, pavarësisht kostove shumë të larta në sigurimin e energjisë elektrike, kemi garantuar për të gjithë tensioni e ulët, që nuk ju ka ndryshuar çmimi, kur çmimet në treg kanë ndryshuar disa herë. Flasim për kontratat në fjalë, çmimi i energjisë i të cilave i ka kaluar të 43-44 lekët për kilovat dhe ata nuk e kanë ndjerë këtë element. Pra, në këtë aspekt, paketa e dytë parashikon t'i përgjigjet përsëri kësaj situatë të veçantë të tejzgjatur, e cila tani po merr edhe ngjyra akoma më të ashpra, më të egra.

Parashikojmë që pjesa tjetër e vitit, 6-mujori i dytë, në energjinë elektrike të jetë më i vështirë për qeverinë, pasi është periudha jonë e thatë, dhe ne do të bëjnë çmos që të kemi një

organizim matematikor të sistemit të energjisë për të ulur sa më pak efektet në buxhetin e shtetit, që të kemi mundësi të mos ndikojmë në shërbime dhe konsume të tjera që ofrohen nëpërmjet këtij buxheti për konsumatorët dhe për tërë ekonominë shqiptare.

Nga ana tjetër, ai bordi që ju thoni, të mbajë nën kontroll akoma më të rreptë të gjithë situatën në mënyrë ditore, edhe javore, por ditore, siç kemi bërë këto 2-3 ditët e fundit, duke reflektuar ndryshimet e çmimit në bazë ditore, jo më të mblidhemi dy apo një herë në javë.

Të jeni të sigurt që ne nuk favorizojmë asnjë prej bizneseve. Vazhdon të mbetet e njëjta situatë, ku marzhi i tyre vazhdon të mbetet totalisht 15 lekë ose më pak se 5,5%.

Në këtë aspekt, them që këto janë masat që ne kemi marrë. Ju jeni ligjvënës, mbetet në dorën tuaj të merrni masa të tjera, të cilat kanë të bëjnë me nivelin e taksave, kanë të bëjnë me kufizimet e konsumit, apo rasti i asaj që është duke projektuar qeveria për konsumet të energjisë elektrike me mbi 700 kilovatë, të cilat kërkojnë një mbrojtje nga tregu të buxhetit të shtetit, por ne të garantojmë më shumë shërbime për konsumatorët. Më shumë se i mirëpresim, jemi të etur të kemi bashkëpunimin tuaj. Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Bejtja, dhe gjithë përfaqësuesve!

Faleminderit gjithë kolegëve deputetë për debatin, të cilin e çmojmë realisht!

Mbledhjen e zbardhur e keni për pak ditë në dispozicion, ndërkohë që, siç e dini, tashmë të gjitha mbledhjet e komisionit transmetohen *online* dhe kushdo mund t’u rikthehet.

Të bëhet gati grupi për projektligjin e radhës!

Hedhim në votim aktin normativ! Ka vetëm një votim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

Do të jemi në kontakt.

Sekretare e Komisionit
Enslemvera Zake

Përgjegjësja e Shërbimit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar administrativ
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.06. 2022, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për krijimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore.

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Arbi Agalliu, Benet Beci, Erion Braçe, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Antoneta Dhima, Edmond Spaho, Enslemvera Zake, Anila Denaj, Pranvera Resulaj,

Mungojnë:

Blerina Gjylameti, Alfred Rushaj, Agron Shehi, Jorida Tabaku, Emilja Koliqi, Dashamir Shehi, Shpresa Marnoj, Bujar Leskaj.

Të ftuar:

Besart Kadia – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Ermal Frashëri – Drejtor i Përgjithshëm i Korporatës së Investimeve Shqiptare

Saimir Muçmataj – Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator

Evis Fico – Këshilltare në MFE

Eduard Shalsi – Kemi projektligjin “Për krijimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”. Është një ligj sa interesant, aq edhe i shumëpritur.

Kemi në komision të ftuar zotin Besart Kadia, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, zotin Ermal Frashëri, drejtor i Përgjithshëm i Korporatës së Investimeve Shqiptare, zotin Saimir Muçmataj, drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, zonjën Evis Fico, këshilltare.

Mirë se erdhët në komision!

Relator për këtë projektligj kemi zotin Benet Beci.

Presim me padurim aplikimin e këtij ligji. Ju përgëzoj për iniciativën. Pa humbur kohë do t’ua kaloj fjalën përfaqësuesve pastaj do të vijojmë me relatorin për të kaluar te pyetjet dhe përgjigjet.

Nga analizimi i projektligjit, relatori do të vendosë theksin te disa pika që ne sugjerojmë do t duhet të ndërhyhet dhe të përmirësohet.

A jeni dakord me rendin? Dakord.

Fjala për përfaqësuesit.

Ju lutem, edhe një kontekst të projektligjit në fjalë.

Fjala për zotin Frashëri.

Ermal Frashëri - Zoti kryetar, shumë faleminderit për mundësinë!

Zonja dhe zotërinj anëtarë të komisionit,

Është kënaqësi që jemi para jush sot për të diskutuar një projektligj, i cili krijon kushtet e favorshme për të nisur një aktivitet të ri në Republikën e Shqipërisë.

Ashtu siç tha edhe kryetari, unë do të dajë të bëja një prezantim të shkurtër të kontekstit dhe të frymës që ka karakterizuar këtë projektligj për t’ju lënë më pas hapësirën dhe kohën për të diskutuar pyetjet, mendimet apo komentet tuaja.

Nëse i shikoni zhvillimet në botë, si në ekonomitë e zhvilluara, po ashtu edhe në ekonomitë në zhvillim, është një garë për të tërhequr talentin dhe për të krijuar kushtet e favorshme industrive për të gjeneruar kërkim dhe zhvillim të produkteve dhe shërbimeve të reja. Pra, të gjitha vendet që synohen të zhvillohen duke rritur kompleksitetin teknologjik të mallrave dhe produkteve janë në një garë për të krijuar kushtet e favorshme rregullatorë për të eksperimentuar dhe për të sjellë inovacion.

Si në vendet në zhvillim po ashtu edhe në vendet e zhvilluara krijohen hapësira në ekosistemin rregullator për ta bërë më të lehtë zhvillimin e kërkimit dhe inovacionit. Si parantezë e kësaj dua të them se nga praktika botërore rezulton se është shumë e vështirë për një ekonomi të zakonshme të bëjë kërkim dhe zhvillim. Pra, edhe nëse shikohet se cilët bëjnë kërkim dhe zhvillim në botë, janë zakonisht kompanitë më të mëdha. Vetëm ato kompani kanë ato lloj kapacitetesh, si njerëzore ashtu edhe financiare, për të investuar në inovacion. Inovacioni është gjë shumë e vështirë për t'u bërë. Shumë shtetet synojnë të krijojnë hapësira lehtësuese në mënyrë që të inkurajojnë inovacionin jo vetëm nga kompanitë më të mëdha, por edhe nga kompanitë e mesme apo të vogla. Pra, kjo bëhet për t'ua bërë më të lehtë atyre që të shpenzojnë për kërkim zhvillim dhe, po ashtu, të marrin talentin e duhur. Fjala kyçe që duhet pasur parasysh është fjala “eksperimentim” për sa i përket krijimit të ekosistemit rregullator. Kjo në funksion të nxitjes dhe aktualizimit të kërkim-zhvillimit. Në momentin ku jemi ne, si vend, sugjerohet që të ketë një projektligj të veçantë për ngritjen e teknoparqeve dhe fryma që e ka karakterizuar këtë projektligj është një frymë minimaliste, duke qenë koshientë që do të jetë përvoja, e cila do të japë informacion apo sinjale për të ditur se çfarë do të rregullohet më tepër me akte ligjore dhe nënligjore. Pra, në momentin kur duam të krijojmë hapësirë në sistemin rregullator për të ngritur dhe favorizuar inovacionet e kërkim-zhvillimit nuk mund të detajojmë shumë gjëra në këtë projektligj, por do t'ia lëmë praktikës, ose përvojës të na japë ato sinjale. Kjo është një lloj qasjeje që ndodh rëndom, nuk është jashtëzakonshme, madje është një qasje e këshillueshme duke pasur parasysh kontekstin apo momentin ku ne ndodhemi.

Çfarë synon projektligji?! Projektligji synon ngritjen, ose krijimin e një baze ligjore për ngritjen e teknoparqeve dhe zhvillimin e tyre. Aty përdoren disa terma, në mënyrë që ta lehtësojnë zbatueshmërinë e projektligjit, si për shembull: zhvilluesi i teknoparkut, menaxhuesi i tij, operatori që hy në park.

Synimi i teknoparkut, këtu bëhet një diferencim midis teknoparkut dhe zonave teknologjike dhe të zhvillimit ekonomik, ose siç quhen në literaturë zonave special-ekonomike, është i tillë që TEDA-t kanë fokus prodhimin në masë dhe, kryesisht, manifakturën, pra, prodhimin në masën seri të mallrave që në shumicën e tyre shkojnë për eksport.

Fokusi i teknoparqeve është kërkim-zhvillimi, pra, thjesht krijimi i prototipeve si në mallra ashtu edhe në shërbime. Pra, ky është një dallim i rëndësishëm midis këtij projektligji dhe

ligjit për zonat ekonomike. Unë kam qenë në këtë komision para 7 vjetësh kur miratohej versioni i fundit i ligjit të TEDA-ve.

Duke qenë se ky projektligj ka një fokus tjetër, është e këshillueshme të jetë ligj specifik.

Për ta përfunduar dhe për t'ua lënë fjalën kolegëve është që ky projektligj do të pasohet, pra krijon bazën rregullatore për të mundësuar identifikimin e zhvilluesve dhe për të lehtësuar futjen e kompanive që kanë synim inovacionin dhe kërkim zhvillimin në teknopark.

Këtu dua ta mbyll fjalën time, duke lënë hapësirën për pyetje, komente apo sugjerime që mund të keni.

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Faleminderit, zoti Frashëri, për shpjegimet!

Zoti Beci, në cilësinë e relatorit, fjala për ju.

Benet Beci - Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Frashëri, për shpjegimet konceptuale të ligjit!

Të nderuar kolegë,

Ashtu siç u prezantua, qëllimi i këtij projektligji është të rregullojë krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore në Republikën e Shqipërisë.

Projektligji propozohet në mbështetje të neneve 78, 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe nuk ka pasur komente në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike në periudhën 7 prill-7 maj 2022.

Ekonomia digjitale, edhe pse është paraqitur më vonë në rajon, po futet në veprimtarinë e përditshme të ekonomisë së tregut më shpejt, duke u bërë një sektor i rëndësishëm ekonomik.

Kalimi nga ekonomia tradicionale në ekonomi digjitale ka nevojë për zhvillim të një ekosistemi të inovacionit, infrastrukturës ligjore, politikave të qarta fiskale dhe sistemit efikas të arsimit, nga niveli primar deri tek ai universitar.

Një hapësirë e tillë ka potencialin të bëhet një qendër jetike për kërkimin, zhvillimin dhe edukimin, me laboratorë dhe ambiente trajnimi, duke ofruar akomodim për fillimin e zgjerimin e bizneseve të reja. Parqet e tilla kanë potencialin për të stimuluar investimet në ndërmarrjet e bazuara në teknologji dhe për të nxitur transferimin e teknologjisë midis subjekteve kërkimore dhe ndërmarrjeve.

Duke pasur parasysh faktin themelor që firmat nuk bëjnë risi të izoluara, por kërkojnë ndërveprime të vazhdueshme për ta bërë këtë, një park teknologjik e shkencor mund të korrigjojë

dështimet e koordinimit dhe të forcojë lidhjet, duke lehtësuar kështu transformimin e njohurive në risi.

Programi mbështetës i ofruar nga formati teknopark u mundëson firmave të aksesojnë lehtësisht burimet e inovacionit dhe të ulin kostot e të bërit biznes.

Me këtë ligj synohet që parqet të kenë statusin e zonës së lirë doganore, që kanë si qëllim: nxitjen e zhvillimit të industrive të teknologjisë së lartë dhe inovacionit; kërkim-zhvillimin për produkte dhe shërbime të reja, si edhe përmirësimin e atyre ekzistuese; krijimin e vendeve më të kualifikuara të punës për profesionistë të fushave të shkencës dhe teknologjisë; krijimin e infrastrukturës teknologjike, me qëllim përshpejtimin e zhvillimit të inovacionit në produkte apo metoda prodhimi; lehtësimin e sipërmarrjes inovative; krijimin e lidhjeve të drejtpërdrejta ndërmjet bazës së njohurive, për shembull, instituteve kërkimore, universiteteve dhe bizneseve; mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme; zhvillimin e kërkimit dhe të inovacionit, prodhimin në sektorin e teknologjisë, si dhe krijimin e një ekspertize me aftësi të larta.

Ky projektligj ndahet në katër kapituj, nga të cilët në kreun e parë parashikohet objekti i ligjit, që lidhet me organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore, qëllimin dhe mënyrën e krijimit. Në kreun e dytë parashikohet organizimi, funksionimit të parqeve dhe institucioneve përgjegjëse. Më tej, në kreun e tretë parashikohet lehtësimi, lehtësitë rregullatore dhe fiskale, si dhe mënyra e hyrje-daljeve të mallrave dhe shërbimeve në park. Në kreun e katërt parashikohen dhe dispozitat rregulluese dhe tranzitore. Efektet financiare që mund të dalin nga zbatimi i këtij ligji do të parashikohen në aktet nënligjore, që do të miratohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Nëse duhet të sqaroj disa propozime për komisionin përgjegjës, siç tha dhe kryetari..

Eduard Shalsi - Në fund.

Hapim siparin e pyetjeve.

Po, zonja Resulaj.

Pranvera Resulaj – Faleminderit, kryetar!

Në fakt, e ndoqa me vëmendje dhe sa herë që bëhet fjalë për çështjet e kërkimit shkencor apo kërkim-zhvillimit është një temë shumë e rëndësishme, por pak e vështirë për t'u kuptuar edhe për t'u materializuar, për hir të së vërtetës.

Dua të di a ka kompani të interesuara në Shqipëri, me të cilat ju keni një lloj bashkëveprimi apo bashkëpunimi? Ndoshta nuk e kuptuam saktësisht sesi është kjo lidhje dhe sesi funksionon, por ndoshta duhet të bëni një rezumë të shkurtër dhe njëherë në terma praktikë

për të kuptuar se cila është mënyra e funksionimit të parqeve teknologjike, lidhja me kompani, të cilat janë në proces manifakturimi, sepse ato janë më të interesuarat për të pasur kërkim-zhvillim në mënyrë të vazhdueshme për të përmirësuar produktin, shërbimin e të tjerë.

Ne kemi miratuar ligjin e start up-eve. Në fakt, star upi është një risi, një ide inovatore rishtaz, ndërsa kërkimi-zhvillimi është një proces, i cili përmirëson gjatë gjithë kohës. A ka ndonjë lidhje, ndonjë bashkëpunim, apo një lloj pike takimi mes parqeve teknologjike, aktivitetit tuaj dhe startup-ve?

Ndoshta janë shumë pyetje, por, ju lutem, mund të bëni një përmbledhje më praktike të mënyrës së funksionimit!

Eduard Shalsi - Zonja Koti, zoti Sinaj. Pastaj zoti Beci,

Sorina Koti- Në vazhdimësi të ligjit për start-up-ve që është i miratuar dhe në eksperiencën e inkubatorëve, të cilët janë ngritur kohë më përpara, të paktën inkubatorit që është ngritur në Korçë dhe në Tiranë, si ka qenë eksperiencia nga inkubatorët, që të kalojmë më pas te parqet teknologjike?

Si janë projektuar dhe si janë zhvilluar në këto inkubatorë bizneset, fondet që u janë dashur atyre dhe më pas të vazhdojmë me parkun teknologjik, i cili është në nivel më të lartë, më të komplikuar, që kërkon më shumë investime, që kërkon më shumë zhvillim-kërkim, kërkon dhe më shumë fonde nga ju?

Sa do të jetë në bashkëpunim parku teknologjik me biznesin dhe bashkitë, si do të procedohet me fondet, me bizneset, me të cilat do të promovohen, ose do të marrin pjesë nga fondi qeveritar, sa për qind do të mbulohen nga vetë ata dhe sa përqind do të mbulohen nga ju?

Eduard Shalsi - Zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj - Ideja është shumë e mirë dhe duket sikur do të mund të krijojmë mundësitë për të mbledhur shkencëtarë jo vetëm të vendit, por edhe të botës. Inovacioni dhe zhvillimi i ekonomisë është për t'u përgëzuar si ide, por problemi është sesi do të realizohet dhe sesi do të filtrohen të gjithë këta shkencëtarë që do të vijnë në Shqipëri, apo ata që janë shpikës të inovacionit në vendin tonë.

Te ligji nuk pashë asgjë në lidhje me Akademinë e Shkencave. Ne kemi një akademi shkencash në Shqipëri, pse nuk keni parashikuar një bashkëpunim apo një ofrim dhe të Akademisë së shkencave në parkun teknologjik? Kjo është pyetja.

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Zoti Beci.

Benet Beci – Kam një pyetje në lidhje me ligjin, tashmë të aprovuar prej shumë vitesh, për zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik. A ka pasur ndonjë implementim të drejtpërdrejtë të atij ligji në ato zona dhe pse?

Eduard Shalsi – Zonja Denaj.

Anila Denaj – Kam një pyetje në raport me nomadët digjitalë. A ka përfshirje të benefiteve fiskale të përcaktuar në këtë ligj? Kam edhe një pyetje, që lidhet me eksperiencat tona të tjera të mira në rajon. Unë di konkretisht që vende në rajon e kanë të zhvilluar këtë dhe me produkte konkrete. A kemi marrë ndonjë referencë prej tyre, çfarë ka funksionuar dhe çfarë jo?

Eduard Shalsi – Po, zoti Xhelili.

Alban Xhelili – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e kam parë me vëmendje projektligjin dhe shoh që ka një përcaktim lidhur me prodhimin, pra, me rezultatin të parkut dhe aty përcaktohet që nuk do të ketë prodhim në seri të produkteve. Pra, nga këtu fillon ai koncepti, që nuk po flasim për një ndërmarrje të mirëfilltë prodhuese, por shikoj një lidhje, e cila nuk më pëlqen, në lidhje me përcaktimin e lehtësive fiskale, ku thotë: “Pesëmbëdhjetë vjet pa tatim, ose me tatim zero, ndërsa pjesa tjetër dhjetë vjet pa asnjë lloj detyrimi fiskal lidhur me stafin, më duket e saktë, dhe ngjashmërinë e produktit të shitur me procedurën e eksportit”. Për çfarë produktesh bëhet fjalë kur flasim për joprodhim sasi, ose të themi produkte, të cilat më shumë do të jenë produkte prove sesa produkte që do t'i shërbejnë masës dhe tregut? Pra, më duket sikur në një moment flitet për tregtinë në një kohë që baza, të cilën unë e vlerësoj, është joprodhuese, por bazë më shumë shkencore.

Faleminderit!

Eduard Shalsi - Faleminderit, zoti Xhelili!

Unë kam një pyetje të fundit. Është folur shumë për zonën e Kasharit, për një projekt konkret shumë kohë më parë, meqenëse m'u desh ta mbuloja për një periudhë disa muajore në cilësinë e deputetit atë zonë, jam i interesuar nëse ka një projekt konkret për një zonë të caktuar, një ose disa projekte, për të zhvilluar në truall shtetëror, në truall privat dhe si është dizenuar procesi dhe vendi?

Faleminderit!

Mund të vijoni me përgjigjet.

Ermal Frashëri - Zoti Kryetar, shumë faleminderit!

Faleminderit anëtarëve për pyetjet!

Unë po e filloj nga pyetja e parë, për përshkrimin e funksionimit të parkut, sepse kam përshtypjen se edhe e përshkrimi i modelit të funksionimit do t'u japë përgjigje edhe disa pyetjeve të tjera. Këtu ideja është se ajo që ndodh rëndom edhe në vende të tjera, që synojnë t'i inkurajojnë kërkimet shkencore, është se krijohet një ekosistem rregullator, por për të lehtësuar barrën që kanë kompanitë për të investuar në kërkim-zhvillim. Pra, i krijohen lehtësi rregullatore, po kështu edhe fiskale, por edhe lehtësi për sa i përket infrastrukturës që ta kenë më lehtë investimin atje. Si ndodh në praktikë? Zakonisht kompanitë e kanë të vështirë t'i ndërtojnë vetë godinat, të ndërtojnë vetë infrastrukturën e përgjithshme, më pas të investojnë. Zakonisht kompanitë duan t'i bien shkurt, thjesht duan të hyjnë në një ambient që t'i bien prizës dhe të fillojnë aktivitetin. E gjithë çështja që ngrihet, është se kush do ta bëjë këtë gjë? Domethënë, të krijojë infrastrukturën e përgjithshme, duke përfshirë godinat, shërbimet publike, shërbimet private dhe këtu hyn koncepti i zhvilluesit. Pra, krijohet një organizatë ose një etnitet, që është zhvilluesi, i cili merr përsipër ngritjen e infrastrukturës, për t'ua vënë në dispozicion kompanive. Domethënë, kjo është hallka e parë e organizimit.

Hallka e dytë ka të bëjë me menaxhimin e parkut, sepse vërtet zhvilluesi mund ta ngrejë atë si park, por zhvilluesi duhet të ketë edhe njohuri të mira për bizneset ose kompanitë që janë të interesuara të shkojnë atje dhe shpeshherë është përdorur termi "menaxhues". Domethënë, ka kompani në botë, duke përfshirë edhe Bashkimin Europian që janë shumë, të cilat merren me menaxhimin e tekno-parqeve. Për shembull, po marr rastin e Finlandës, kur arrin në Helsinki, udhëton nëpër Helsinki, shikon plot godina të destinuara për të qenë teknoparqe, që popullohen nga kompani të ndryshme. Pra, hallka e dytë e organizimit të teknoparqeve është menaxhuesi, i cili ka aftësinë për të njohur tregun dhe për bërë filtrin e parë se cilat nga kompanitë janë të interesuara për të shkuar atje. Menaxhuesit ose zhvilluesit interesohen që ta popullojnë parkun me kompani, në mënyrë që të rrisnin produktivitetin, sepse është edhe kjo ideja që kompanitë zor që të krijohen inovacion, në izolim nga njëra-tjetra. Prandaj, në qoftë se shikoni si funksionojnë zonat ekonomitë speciale, ato funksionojnë, sepse mbledhin shumë kompani brenda. Domethënë, krijon gravitet në zonat ekonomike, po kështu edhe nga teknoparqet.

Hallka e tretë e organizimit janë vetë kompanitë që vijnë popullojnë teknoparkun. Tani si bëhet popullimi i tyre? Këtu hyn fort bashkëpunimi që ka menaxhuesi me zhvilluesin e teknoparqeve që mund të jenë 1 etnitet ose mund të jenë të ndryshme. Zakonisht janë të

ndryshme, sepse duhet të kesh njohuri të caktuara, një *know-how* për të tërhequr firmat për të ditur se cilat nga firmat kanë potencial për të investuar në kërkim-zhvillim për të ndaluar abuzimet që mund të ndodhin. Pra, kur bëhet fjalë se cilat kompani do të shkojnë në teknopark, kjo është një pyetje që ka të bëjë me biznesin dhe është zor që në këtë moment të thuash se e di ekzaktësisht se cila firmë do të shkojë atje. Zakonisht firmat që hyjnë atje, janë firma që kanë një aktivitet ekzistues të madh, kanë kapacitet për të rritur prodhimin, pro jo thjesht rritje prodhimi, por krijimi i një linje të ri të prodhimit, sepse inovacioni nuk është thjesht në faktin e rritjes së volumit të prodhimit, por në krijimin e produkteve apo shërbimeve të reja. Pra, fokusi i parë do të jenë ato kompani që kanë masë kritike për të bërë të mundur kërkim-zhvillimin. Rëndom në literaturë ata quhen investitorë-spirancë dhe fakti që një ose dy nga ato kompani vijnë, hyjnë në teknopark, që mund të jenë kompani vendasve dhe të huaja, atëherë ato fillojnë të krijojnë mjaftueshëm gravitet që edhe kompani të tjera të fillojnë të interesohen të krijojnë fondet e tyre për të investuar në kërkim-zhvillim. Ky është modeli i praktikës apo i funksionimit të teknoparkut. Nuk e di nëse iu përgjigja plotësisht pyetjes...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është herët që t'i përgjigjesh asaj pyetjeje.

Në lidhje me bashkëpunimin me bashkitë dhe bizneset, normalisht që për ngritjen e teknoparkut do të ketë një bashkëpunim intensiv me partnerët në territorin e të cilëve do të ngrihen teknoparket, pra këtu hyjnë bashkitë. Pra, bashkëpunimi me bashkitë apo me institucionet e tjera vendore dhe qendrore është e natyrshme dhe presupozohet se është gjëja më e zakonshme, nuk ka asnjë lloj pengesë konceptuale, madje lind si nevojë detyrimi për të zbatuar projektin që të ketë një bashkëpunim të fortë me qeverinë vendore.

Në lidhje me pyetjen e tretë, që fliste për situatën me akademinë, në fakt, është një pyetje shumë e drejtë, në mënyrë që një teknopark të funksionojë mirë, edhe praktika botërore sugjeron një institucion universitar brenda dhe në ligj parashikohet një gjë e tillë, pra parashikohet që ngritja e teknoparkut ndodh atëherë kur ka edhe një institucion të arsimit të lartë vendas apo të huaj. Pra, është parashikuar në ligj ky lloj bashkëpunimi midis industrive dhe institucionit të arsimit të lartë.

Pyetja në lidhje me zonat ekonomike (TEDA), këtu ka dy aspekte: aspekti i parë është që TEDA-t kanë si synimi manifakturën dhe prodhimin në seri të mallrave, që mund të shkojnë si për eksport, madje unë dëshiroj që të shkojnë për eksport të brendshëm, nëse ndodh, duke

aplikuar më pas të gjitha taksat që aplikohen rëndom në tregun vendas. Synimi i teknoparkut është jo prodhimi në seri dhe kërkim-zhvillimi. Pra, fokusi është pak i ndryshëm, kurse në lidhje me eksperiencën për sa u përket TEDA-ve është që në praktikë ka rezultuar e vështirë të gjendet zhvilluesi i zonave speciale ekonomike.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në këtë rast fokusi është të krijohen ato kushte, në mënyrë që gjetja e zhvilluesit të bëhet më e lehtë dhe mund të ngarkohen autoritetet publike, po kështu autoritetet gjysmë publike dhe gjysmë shtetërore, pra kompani shtetërore, për të marrë përsipër rolin e zhvilluesit. Kjo do të mundësonte ngritjen e teknoparkut. Ajo që kërkon tregu këtu, është se, kur vjen puna të përcaktimi i rolit të zhvilluesit, donte një siguri më shumë nga shteti. Zakonisht një mënyrë, që ndodh rëndom për ta aktualizuar këtë, është se rolin e zhvilluesit e marrin kompanitë shtetërore. Domethënë, përcaktohet një kompani shtetërore që merr përsipër rolin e zhvilluesit. Kjo kompani identifikon menaxhuesin e teknoparkut për të sjellë atë njohuri, *know-how*, që duhet për funksionimin e tij, më pas identifikimin e firmave. Pra, synimi është të gjendet një ent, një nga institucionet publike, ose një kompani shtetërore që të marrë përsipër të bëjë rolin e zhvilluesit. Kjo është një situatë ideale.

Në lidhje me pyetjen për raportin me nomadët digjitalë, këtu mund të ketë një bashkëpunim midis tyre, por fokusi i punës së tyre është i ndryshëm, nëse një nomad digjital ose disa nga ata synojnë të krijojnë një inovacion, ose synojnë që të fokusohen në kërkim-zhvillim, atëherë mund të krijohen hapësira që ata të marrin pjesë në teknopark. Në qoftë se një nomad digjital thjesht bën punën e zakonshme, atëherë teknoparku nuk është vendi i duhur i tij ose i saj. Pra, këtu ideja është se edhe filtrat, që janë parashikuar në ligj, janë bërë të tillë që të ketë një kontroll se cili hyn në teknopark, duke pasur parasysh edhe lehtësitë fiskale apo rregullatore që marrin ata persona apo etnitete që hyjnë brenda.

Në lidhje me pyetjen për standardet nga vendet e tjera, në fakt, teknoparket, ashtu siç thashë më lart, janë një fenomen që ndodh gjerësisht si në vendet e zhvilluara aktualisht, po kështu edhe në vendet në zhvillim. Pra, në Bashkimin Europian funksionojnë gjithandej, ka disa politika të rëndësishme të Bashkimit Europian për inkurajimin e teknoparqeve. Ka në shumicën e vendeve në rajon, pra ka edhe në Kosovë, që është ngritur së fundi nëpërmjet asistencës së GIZ-it, në Prizren, ka edhe në të gjitha vendet e tjera të Azisë Lindore, pra në vendet e Amerikës Veriore, pra nuk janë thjesht koncepte teorike, por janë realitete.

Në lidhje me aplikimet e lehtësive fiskale, këtu ideja është se lehtësitë fiskale janë të ngjashme me lehtësitë që parashikohen në ligjin e TEDA-ve, po kështu janë lehtësi fiskale të përballueshme nga shteti, pra nuk janë lehtësi që i kalojnë kapacitetet apo mundësitë e shtetit për t'i dhënë ato; janë, pak a shumë, brenda tipologjisë së lehtësive fiskale që përdoren edhe nga ligjet e ngjashme në vendet e tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Alban Xhelili – Unë do ta çoja pak më tej atë pyetjen që kisha. Dua të them se në projektligj është përcaktuar që edhe qeveria shqiptare duhet të krijojë akses, pra duhet të krijojë të gjithë infrastrukturën deri te zona. Duke marrë parasysh pjesën që një pjesëtar i kësaj zone mund të zhvillojë një aktivitet kërkues, jo në produktin e tij, por në çfarëdolloj produkti tjetër, mjafton që të jetë një inovacion dhe mund të jetë një markë ose një patentë e re, nesër mund ta shesë këtë, pra ne përcaktojmë në ligj të gjitha detyrimet tona për t'iu përgjigjur këtij parku. Cilat janë përfitimet?

Faleminderit!

Ermal Frashëri – Faleminderit për pyetjen, sepse është edhe thelbi i gjithë gjësë, pra pse synojmë t'i ngremë teknoparqet dhe çfarë synojmë të arrijmë nëpërmjet atyre. Dua të them se përfitimet, që vijnë nga teknoparku, janë të tilla që i shërbejnë zhvillimit të ekonomisë shqiptare dhe evoluimit të saj në një stad tjetër. Pra, nëse lëshojmë trajektoren e zhvillimit të ekonomisë shqiptare, ne jemi në një pikë që do të bëjmë disa kapërcime, qoftë edhe kapërcime strategjike, në mënyrë që të arrijmë një diversifikim të saj, po kështu edhe një kalim në një nivel më të lartë teknologjik, sepse edhe vetë koncepti i zhvillimit ekonomik të një vendi vjen si pasojë e diversifikimeve ekonomike dhe rritjes së teknologjisë, më specifikisht kompleksitetit teknologjik. Pra, përfitimi nëpërmjet këtij ligji ose nëpërmjet ngritjes së teknoparkut vjen nga krijimi i një baze njohurie në vend, i cili krijon më pas konsekuenca. Pra, në fund të ditës ajo që i intereson Shqipërisë, është që të krijojë mjaftueshëm njohuri dhe kapacitete, të cilat mund të krijojnë më pas aktivitete të reja ekonomike. Domethënë, për të krijuar një aktivitet të ri ekonomik në bazë, duhet të kesh njohurinë, po të mos kesh njohurinë, nuk bën dot asnjë lloj aktiviteti të ri. Këtu thelbi është: si krijohet kjo njohuri? Është shumë e vështirë që kjo njohuri të krijohet vetvetiu dhe është më e lehtë që kjo njohuri ose të silllet nga jashtë, ose më pas të kultivohet në vend nëpërmjet incentivimit ose lehtësimit të saj. Thelbi këtu është krijimi i një baze njohurie e cila më pas mundëson diversifikimin ekonomik, pra është në interes të shtetit për

të krijuar lehtësi për të tërhequr talentin. Pra, dua të them edhe një fjalë dhe e mbyll këtu. Unë e thashë dhe më parë, nëse shikon ekonominë e zhvilluara, dhe angazhimi që unë kam më lejon të kem këtë lloj ballafaqimi me vendet dhe qeveri të ndryshme, është i tillë që janë në një garë të madhe për të tërhequr talentin. Domethënë, si në formën e ngritjes së kllasterave, ku mbledhet njohuria nëpërmjet liberalizimit të ligjeve për migrimin. Për shembull, Anglia miratoi një ligj para 3-4 javësh, ku u jepte viza pune pa asnjë lloji kufizimi atyre personave, të cilët dalin nga një numër i caktuar universitetesh. Për shembull, në Emiratet e Bashkuara Arabe ata janë prej 10 apo 20 vjetësh në një drejtim që duan të mbledhin sa më shumë talente dhe mundohen ta hapin sa më shumë ekonominë e tyre, në mënyrë që të përthithin talentin e duhur që ta çojë ekonominë në një fazë tjetër zhvillimi. Madje, edhe për kuriozitet në Emiratet e Bashkuara Arabe 2/3 e sektorit publik janë të huaj, domethënë që nga pozicioni i këshilltarëve deri te pozicionet ekzekutive, pra kanë bërë një hapje të sektorit publik dhe një eksperimentim si në zonat ekonomike, po kështu dhe në zonat e teknologjisë që të jep mësim të mjaftueshëm për të parë çfarë hapësirash krijojnë shtete të ndryshme për të inkurajuar inovacionin dhe për të tërhequr talentin.

Alban Xhelili – Mos ndoshta duhej të kishim shkuar pak më larg me këtë projektligj që të kishim parashikuar dhe për ata, të cilët do të kenë një rezultat pozitiv në kërkim-zhvillim dhe produkti i tyre apo aktivitetit i tyre tregtar, që do të zhvillohej, po të zhvillohej në Shqipëri, do të kishte ca incentiva ose ca lehtësira, pra që ta stimulojmë, sepse e lidh gjithmonë me diskutimin e mëparshëm. Ne mund të krijojmë goxha lehtësira këtu dhe ai mund të na i shesë komplet patentën, komplet produktin jashtë në një vend tjetër, pra çfarë duhet të bëjmë që ta çojmë më tej këtë që t'i stimulojmë?

Ermal Frashëri – Në fakt, është pyetje e drejtë: janë dy momente, një është që në princip, do të thosha, një ekuilibër nëpërmjet tërheqjes së investitorit ose kompanisë, si dhe krijimit të lirisë që ata të krijojnë, më pas e vendosin vetë se ku do të shkojnë. Pra, nuk e shtrëngon shumë detyrimin që ata të qëndrojnë në Shqipëri. Domethënë, në krijimin e kësaj balance, zinxhiri mund të jetë i tillë që një produkt mund të krijohet ose të shpiket në teknopark, pra miratohet prototipi, më pas kalon në prodhim në seri në TEDA që ekzistojnë. Domethënë, konceptualisht një zinxhir i tillë mund të funksionojë. Pra, i thua një investitori që ti, në qoftë se vjen e shpik një produkt në teknopark, atëherë e ke më kollaj që të të zhvendosesh në TEDA, ku përsëri ke lehtësi fiskale, rregullatore, ke ekosistemin, jo thjesht rregullator, por infrastrukturën për ta kaluar prodhimin në seri, pra ekziston, nuk ka një boshllëk rregullator apo konceptual,

ekziston ai këtu. Në fakt, këtu për ta përdorur si një mënyrë për t'i përgjigjur pyetjes së kryetarit për projektet në zonën e Kasharit, është një projekt që është iniciuar nga Bashkia e Tiranës para disa vjetësh për të ngritur një zonë ekonomike speciale, pra një TEDA në një zonë të Kasharit. Një nga diskutimet që është duke u trajtuar është përdorimi i një pjese të tedës, pikërisht për të krijuar këtë zinxhirin midis teknoparkut edhe tedës. Pra, një pjesë e zonës mund t'i dedikohet teknoparkut dhe pjesa tjetër i dedikohet tedës. Në këtë mënyrë, edhe fizikisht, ndoshta është më e lehtë edhe për kompanitë, që të fillojnë aktivitetin e prodhimit në seri, pasi të kenë përfunduar ciklin e kërkim-zhvillimit të një produkti të caktuar.

Eduard Shalsi - Faleminderit, zoti Frashëri për shpjegimet!

Para se të kalojmë te miratimi i ligjit, kam edhe dy kërkesa të fundit nga zoti Spaho dhe nga zonja Dhima. Pastaj, zoti Beci ka disa sugjerime, të cilat do t'i propozojë dhe do ia kalojmë komisionit përgjegjës.

Zoti Spaho.

Edmond Spaho – Dy konsiderata shkurt, dua të jap. Kjo duket kaq e bukur si ide, sa e ke të vështirë ta besosh, veçanërisht, kur krahasohet me Anglinë dhe me vendet arabe dhe të tjera. Më shumë duket si një dëshirë juaja për ta ofruar sesa një realitet që ka kërkesa për të ndërtuar gjëra të tilla në Shqipëri. Pse e them këtë? Ju mund të mos bini dakord, por shikoj kompanitë shqiptare më të mëdha që kemi ne, me se rrojnë? Me tendera, me ndërtime në bregdet, fshatra turistike, që shiten tek individët. Pra, marrin prona publike me 1 euro, marrin koncesione apo aktivitete shtetërore në përdorim për të nxjerrë fitim. Nuk shikoj ndonjë nga kompanitë shqiptare që të investojë në kërkim – zhvillim.

Së dyti, universitetet shqiptare, që duhet të jenë zemra e kërkim-zhvillimit, më thoni cili prej tyre merret me kërkim-zhvillim? Edhe ato që pretendojnë se merren me kërkim-zhvillim, bëjnë sikur merren.

Së treti, edhe për investitorët e huaj, se ne vuajmë për investime të huaja, në kuptimin që të vijnë të prodhojnë ato produkte që kanë shpikur në vendet e tyre. Nuk po na vijnë investitorë, le pastaj të presim të vijnë këtu, të bëjnë shpikje dhe pastaj t'i prodhojnë. Kështu që, jam shumë skeptik, sepse ky duket nga ato ligjet që janë më shumë për të bërë diçka të re apo ndryshe, duket dëshirë për ta inkorporuar në realitetin shqiptar, por nuk janë kushtet.

Eduard Shalsi – Zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit përfaqësueseve të ministrisë për prezantimin e këtij projektligji!

Në fakt, ndërtimi i parqeve teknologjike ka një rëndësi të veçantë, sepse jo vetëm që garanton krijimin e lidhjeve midis kërkimit, arsimit, bizneseve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe një klime të favorshme investimi, por gjithashtu shërben edhe si një pararojë e inovacionit, duke çuar edhe në rritjen e konkurrencës.

Në kohën që ne jetojmë, inovacioni është bërë një element shumë i rëndësishëm dhe një element i rritjes ekonomike dhe njëkohësisht i mirëqenies. Po kështu, ai u jep mundësinë firmave të aksesojnë lirshëm burimet e inovacionit dhe njëkohësisht të ulin kostot e të bërit biznes.

Duke u nisur nga qëllimi dhe nga synimet që ju keni pasur për të propozuar këtë projektligj, cilat janë me përafërsi kostot ose efektet financiare që do të ketë ky projektligj? Keni bërë ndonjë përlllogaritje? Pasi në relacionin që shoqëron projektligjin nuk kemi një kosto dhe thuhet që ato do të llogariten pasi të miratohet ky projektligj.

Faleminderit!

Ermal Frashëri – Shumë faleminderit për komentet dhe për pyetjet!

Në fakt, është normale që të keni skepticizëm për projekte të tilla, nuk është asgjë e jashtëzakonshme.

Faleminderit që e artikulluat këtë gjë!

Komenti im për këtë gjë është që në momentin që ndodhemi, është e vështirë që thjesht të rrimë dhe mos bëjmë gjë. Pra, në këto momente duhet të jemi sa më aktivë, për të eksperimentuar dhe për të krijuar ato lloj hapësirash, të cilat inkurajojnë biznesin të inovojnë dhe ta kthejmë vëmendjen drejt kërkim-zhvillimit, duke i stimuluar ato dhe duke ua bërë më të lehtë.

(Deputeti Edmond Spaho flet pa mikrofon nga salla.)

E kuptoj.

Pra, më tepër është një hap për ta çuar ekonominë shqiptare në një fazë tjetër zhvillimi. Kjo është ideja. Pastaj është testi i praktikës apo i përvojës, për të parë se cilat nga kompanitë shqiptare apo të huaja do të kenë vërtet interes për të ardhur në teknopark.

Po kështu edhe për universitetet, në projektligj është lënë e hapur si për universitet shqiptare edhe për universitetet e huaja, duke pasur parasysh që universitetet e huaja mund të kenë kapacitete ose njohuri më të mëdha për sa i përket bashkëpunimit me industrinë, po kështu edhe me kërkimin shkencor.

Kurse për pyetjen në lidhje me kostot e projektit, ajo që është shkruar në relacion nuk është një koment evaziv, më tepër është reflektimi i statusit të njohurisë apo të realitetit, në sensin që do të jetë vetë testimi i projektit dhe përballja si me zhvilluesit, ashtu edhe me menaxhuesit, dhe në fund me kompanitë, që do të japë inpute apo informacion sesa do të kushtojë ndërtimi i këtij teknoparku. Domethënë, kostot mund të variojnë nga një teknopark në një tjetër.

Për shembull, unë përmenda rastin e Helsinkit, atje ka shumë godina të shtrira në të gjithë qytetin që nga aeroporti deri brenda në qytet, që janë të dedikuara për kërkim – zhvillim. Pra, është vështirë të dalësh apriori me një kosto këtu.

Se di nëse keni pyetje apo komente të tjera?

Eduard Shalsi – Zonja Resulaj, ka kërkuar fjalën.

Me shpejtësi, ju lutem!

Pranvera Resulaj – Një koment të shkurtër kam.

Unë pyeta, a ka kompani shqiptare të interesuara për kërkim – zhvillim dhe në fakt dua të pyes, po universitete të interesuara a ka?

Meqenëse jemi te çështja e skepticizmit, unë e di se çfarë ofrojnë universitetet dhe ato duhet të krijojnë bazën e kërkim-zhvillimit, por meqenëse nuk e kanë bërë dot universitetet, bëjeni ju dhe të mos jemi skeptikë. Pra, le ta bëjnë kërkim-zhvillimin parqet teknologjik, qendrat tuaja dhe le t'i tërheqin edhe universitetet në këtë proces. E rëndësishme është që kjo të bëhet një ditë dhe ndoshta ka ardhur koha. Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Resulaj!

Po, zoti Beci.

Benet Beci - Nga analizimi i projektligjit, kryetar, për saktësim dhe teknikë legjislativë, do të kaloj disa sugjerime që kemi për komisionin përgjegjës.

Në nenin 2, shkronja “a”, përkufizimin “infrastrukturë e përgjithshme”, sugjerojmë të bëhet kështu: “Infrastrukturë e përgjithshme”, ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”.

Në nenin 6 të projektligjit sugjerohet shtimi i një pike 3, me qëllim delegimin e kompetencës Këshillit të Ministrave dhe të formulohet kështu: “Këshilli i Ministrave miraton rregullat mbi mënyrën e organizimit dhe drejtimit, si dhe përgjegjësitë e agjencisë ose organeve

drejtuese të saj, kriteret për zgjedhësit e organeve drejtuese, legjislacionin rregullues të marrëdhënieve të punës, si dhe miraton strukturën dhe organikën e agjencisë”. Ky është ndryshimi i propozuar për nenin 6, në pikën 3.

Në nenin 10 të projektligjit, sugjerohet që pika 3 të hiqet, duke mos lejuar aprovimin e një licence apo që leja të miratohet në heshtje.

Në nenin 12 të projektligjit, në shkronjat “dh” dhe “e”, parashikohet përjashtimi nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe nga taksa e pasurisë së paluajtshme për një periudhë 10-vjeçare për ndërtimet e realizuara në park. Ndërkohë, sipas nenit 9 të projektligjit, zhvilluesi për miratim nga Këshilli i Ministrave ka të drejtën e përdorimit të pronës së paluajtshme shtetërore. I sugjerohet komisionit përgjegjës, që të përcaktojë se cili do të jetë statusi i ndërtesës së ndërtuar nga zhvilluesi mbi tokën shtetërore pas kalimit të afati 20-vjeçar të përdorimit të tij, ndërkohë që ka përfituar edhe përjashtimet sipas shkronjave “dh” dhe “e” të nenit 12 të projektligjit. Kjo ishte për nenin 12.

Për nenin 13 sugjerohen këto ndryshime, pika 1 të riformulohet me këtë përmbajtje: “Në park hyjnë dhe dalin të gjitha mallrat dhe ofrohen të gjitha shërbimet e nevojshme, pavarësisht nga natyra, cilësia, origjina, prejardhja ose vendmbërritja e tyre, me përjashtim të mallrave, importimi, eksportimi ose tranzimit i të cilave është i ndaluar në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi”.

Pika 2 e po këtij neni, sugjerohet të riformulohet me këtë përmbajtje: “Furnizimi i shërbimeve, të ofruara ndaj zhvilluesit dhe/ose përdoruesit të shërbimit brenda parkut përfiton të gjitha lehtësitë, që zbatohen për eksportin e furnizimit të shërbimeve”.

Dy ndryshimet e fundit janë për nenin 18 të projektligjit, sugjerojmë ndryshimin e nenit, duke u reduktuar në këtë përkufizim: “Ky nen për teknikë legjislative të përbëhet vetëm nga fjalia e parë e tij”. Fjalia e dytë e nenit 18 sugjerohet të bëhet një nen më vete, se është fjala për hyrjen në fuqi. Pra, kjo fjali të kalohet si nen 19 për hyrjen në fuqi: “Ky ligj hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

Këto janë sugjerimet e propozuara për komisionin përgjegjës.

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Beci!

Atëherë, falënderoj kolegët deputetë edhe për pyetjet, edhe për sugjerimet!

Kalojmë te miratimi i projektligjit, për t’ia kaluar me sugjerimet përkatëse, komisionit përgjegjës, atij për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisit.

Atëherë, e hedhim projektligjin në votim në parim. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 17. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 18. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 19 i shtuar. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Në tërësi. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Duke ju falënderuar për ligjin, zoti Frashëri, presim dhe do ta ndjekim me shumë interes aplikimin e këtij ligji!

Punë të mbarë. Faleminderit!

Sekretare e Komisionit
Enslemvera Zake

Përgjegjësjë e Shërbimit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar administrativ
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.06.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i draft-rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të KLSH-së për vitin 2021.

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Arbi Agalliu, Benet Beci, Erion Braçe, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Antoneta Dhima, Edmond Spaho, Enslemvera Zake, Anila Denaj, Pranvera Resulaj.

Mungojnë:

Blerina Gjylameti, Alfred Rushaj, Agron Shehi, Jorida Tabaku, Emilja Koliqi, Dashamir Shehi, Shpresa Marnoj, Bujar Leskaj.

Eduard Shalsi - Atëherë, kemi rezolutën e KLSH-së, të cilën e kemi debatuar dhe dakordësuar edhe me KLSH-në. Kemi diçka për të shtuar?

Ndërkohë për parantezë, ju them të bëhemi gati edhe për krijimin e një nënkomisioni parlamentar për Kontrollin e Lartë të Shtetit, sepse në bazë të progresraportit, ky nënkomision është një kërkesë vazhdueshme e Komisionit European. Në këtë kuadër, me Kontrollin e Lartë të Shtetit do të kemi një raport akoma edhe më të detajuar, në krahasim me institucionet e tjera. Atëherë, para se t'ia kalojmë seancës plenare rezolutën, ditën e enjte do të raportojë edhe kryetari.

Ndërkohë, zonja Zake, ka diçka për të shtuar.

Enslëmvera Zake – Faleminderit kryetar!

Lidhur me pikat që ne jemi dakordësuar me anëtarët e komisionit edhe të opozitës për projektrezolutën, jemi dakord me heqjen e pikës 11, po në vijim të asaj që keni thënë edhe ju, e cila do të vendoset në memorandumit e nënkomisionit.

Gjithashtu, edhe me pikën 5 biem dakord.

Ndërsa kam një sugjerim lidhur me pikën e parë, ku po e citoj, në projektrezolutë thuhet: “Auditimet e performancës të fokusohen në auditime sistemi, duke riklasifikuar fushat audituese, duke marrë në konsideratë edhe kritere të tjera si prioritete qeverisëse dhe peshën sektoriale në buxhetin e tyre”. Mendoj se këtë pikë duhet ta riformulojmë, pasi ne dimë që në kuadër të punës dhe funksionimit të KLSH-së, KLSH-ja organizohet në 5 lloje auditimesh që janë: auditimi i përputhshmërisë; auditimet financiare; auditimet e performancës; auditimet e sistemeve të teknologjisë së informacionit, si dhe auditimet e inovacionit dhe sistemeve.

Gjithashtu, ka edhe dy lloj auditimesh të tjera që mund të jenë auditimet e kombinuara, ku ndërthuren 2 ose 3 auditime, gjithashtu edhe auditimet tematike që janë për një çështje apo specifike të caktuar. Kështu që, nëse ne qëndrojmë vetëm te formulimi “auditimet e performancës”, ne kufizojmë punën monitoruese të KLSH-së dhe përjashtojmë nga gjithë suaza e punës 1-vjeçare e auditimeve të KLSH-së 4 auditimet e tjera, duke u fokusuar vetëm tek auditimet e performancës. Pra, mendoj që ta riformulojmë në formë të tillë: “KLSH-ja të fokusohet në auditime sistemi, duke riklasifikuar fushat audituese, duke marrë në konsideratë edhe kritere të tjera si prioritet qeverisëse dhe ato subjekte që mbajnë peshën sektoriale buxhetore”. Në qoftë se edhe anëtarët e tjerë të komisionit janë dakord, duke përfshirë të gjitha llojet e auditimeve që kryen KLSH-ja. Faleminderit!

Eduard Shalsi – Për hir të së vërtetës, kemi pasur një komunikim të vazhdueshëm, siç kemi bërë edhe me institucionet e tjera të pavarura, mbi pikat e rezolutës së KLSH-së.

Kishit diçka për të shtuar?

Po, zonja Koti.

Sorina Koti – Përsëri, duke dakordësuar projektrezolutën, kemi pikën 5 ku nuk mund ta lëmë KLSH-në të publikojë raportet pa një afat të caktuar në faqen e tij të *web-it*, kështu që është përcaktuar, që KLSH-ja duhet të publikojë në vijimësi raportet e aludimit në faqen e *web-it* për një afat kohor brenda 60 ditësh. Ky është një sugjerim, i cili kërkon miratim.

Eduard Shalsi – Besoj se i mbajtët shënim sugjerimet e zonjës Zake dhe të zonjës Koti, do t'ia kalojmë seancën plenare.

(Diskutime pa mikrofon)

Po, kemi një sërë pikash të cilat i kemi mbajtur shënim në fakt. E mbyllim për sot mbledhjen. Ndërkohë, nesër kemi mbledhje dhe ju lutem, ta fillojmë në orën 10:00.

Kemi dëgjesë me kandidatët për Autoritetin e Konkurrencës dhe kemi 4 kandidatura për dy pozicione. Besoj se janë njoftuar të gjithë.

Kjo është çështja e vetme që kemi për nesër, ndërkohë që është parashikuar edhe për seancën parlamentare. Në rregull.

Faleminderit të gjithëve, kolegë deputetë!

MBYLLET MBLEDHJA

**Sekretare e Komisionit
Ensemvera Zake**

**Përgjegjësja e Shërbimit të Redaktorëve
Euzheni Pengili**

**Sekretar administrativ
Elvi Prifti**